


Piktori dhe shkrimtari Rexhep Ferri në një udhëtim rrëfyes se si piktura dhe letërsia kanë nxitur tek ai pyetjet më të mëdha të jetës, duke iu përgjigjur gjatë gjithë kohës me zbulimin e vetvetes – një artist që shkruan poetikisht, duke krijuar një bibliotekë kulturore për gjithë hapësirën shqiptare, me botimin e kompletit të veprës letrare

REXHEP FERRI TANI PO MË TËRHEQIN VETËM GABIMET E BUKURA...



Portreti nga Ina Lajthia

OPINION

DY FJALË SHQIP NË KROACI

Nga Azem Deliu

(fq. 4)

Dy parathënie të autorit shkruar për versionin e veprës së tij të plotë (2009) dhe ribotimin, si libër më vete (2015), të sprovës "Uragani i ndërprerë: Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe".



KADARE: ËSHTË E DREJTË E ÇDO AUTORI TË ZGJEDHË VERSIONIN QË I DIKTON NDËRGJEGJJA E TIJ

MUZEU I KULTURËS FRANCESKANE



SI E RIKRIJONTE BOTËN NË ART PIKTORI LIN DELIJA

Nga Ardian Ndreca

(Fq. 12)

Leximi i poezisë "Mjeseve mundesh me ba sende me dritën" të Ledia Dushit — Nga Entela Tabaku

(Fq. 5)

Zef Zorba dhe një trini poetësh: Montale, Quasimodo, Ungaretti — Nga Suadela Balliu

(Fq. 11)

Revista "Jeta e re" në Kosovë, për letërsinë dhe kritikën

(Fq. 13)



(Fq. 14)

ÇFARË TË BËJMË ME MAJAKOVSKIN

Nga Vittorio Strada

BOTOHET NË LONDËR NJË ANTOLOGJI E POEZISË BASHKËKOHORE SHQIPTARE

(fq. 5)



BIBLIOTEKË



ERVIN HATIBI

VAJZAT E
TRANZICIONIT

Piktori dhe shkrimtari Rexhep Ferri në një udhëtim rrëfyes se si piktura dhe letërsia kanë nxitur tek ai pyetjet më të mëdha të jetës, duke iu përgjigjur gjatë gjithë kohës me zbulimin e vetvetes – një artist që shkruan poetikisht, duke krijuar një bibliotekë kulturore për gjithë hapësirën shqiptare, me botimin e kompletit të veprës letrare

REXHEP FERRI TANI PO MË TËRHEQIN VETËM GABIMET E BUKURA...

Intervistoi: Violeta Murati

I keni kaluar të 80-tat. Besojmë se njeriu ka një fjalë, mendim, se me çfarë filozofie e ka drejtuar jetën e tij – gjithnjë mbi përvojën që ju keni e që është mjaft e pasur: në pikturë dhe letërsi?

Me rastin e 80-vjetorit të lindjes sime, në ekspozitën time nuk isha vetëm unë. Aty ka qenë edhe dikush tjetër. Njeriu gjithmonë e ka një pse dhe një pyetje. Mirë e keq, për ta kuptuar vetveten. Për t'ia falur jetën një humbësi të lumtur. Me shumë dhembshuri hyra në botën e pikturës e të poezisë dhe, deri tani, letërsia dhe piktura kanë qenë besimi im që e ka përcaktuar fati im. Kur na mbushet syri me kohën që jetojmë dhe kur flasim për natyrën që na tërheq. Por, kur vjen ndërrimi i shekullit, rrallohen ëndrrat. Si frymë shqetësimi mund të jap ende dhe deri kur, nuk e di.

U lindët në Kukës dhe vetiu historia: si u ndodhët në Kosovë? Është moment që na kuriozon, cila qe fëmijëria juaj? Si u rritët dhe e morët formimin?

Lindja ime në Kukës nuk ka qenë rastësi. Familjet që i

ka prekur krahu i historisë, në rruazat e kuqe të gjakut e kanë edhe një humbës të lumtur. Kështu na ishte dikur. Tani këtë titull e ka vepra ime e parë. Gjysh pas gjyshi historinë e jetës së tyre e kisha mbi supë. Si krijues kam ikur nga shprehjet e thata artificiale. Jo për ta fituar xhenetin, por për ta gjetur vetveten. Me shpresë se do të bëhet mirë.

Atdheu dhe vetvetja, familja, nga një lexim mbi biografinë tuaj, duket se ka qenë një dhimbje e përhershme?

Gjatë viteve që në Kosovë quheshin “Koha e Shqipërisë”, ministri i Arsimit i Shqipërisë, Ernest Koliqi, me dekret shtetëror, tim atë, mësuesin Shaban nga vendlindja ime Kukësi, e dërgon në Plavë për të hapur shkollën shqipe. Atëherë unë isha dy apo trevjeçar, por ndoshta me fjalët e nënës dhe nga fjalët e nënës, nga ai udhëtim diçka më kujtohet ose vetëm mendoj se më kujtohet.

Për të mos e shqetësuar më shumë vetveten, nuk

po flas për krenarinë. E vetmja punë që duhet të bëj tani, është se s’di ç’të bëj. Si erdha deri këtu kaq shpejt, as gurët kilometrikë të rrugëve nuk flasin. Atdheu cakton dhe përcakton hyrjen në jetë. Kjo dashuri e çmuar, me vetëdije, gjithmonë më ka shqetësuar dhe më ka mbajtur gjallë për ta dashur jetën. Gjatë këtij udhëtimi, besimi në vetvete nuk lë vend për zbulime mashtruese. Më 1973, për krijimtarinë time Anton Pashku shkruan: “Ferri nuk vuan nga infantika, zhurma, nga theksimi i tepruar. Por, gjithashtu, ai nuk lodhet për një lloj zbulimi cikërrimtar që të afron të thatën në vend të së gjallës. I ushqyer me copëza të traditës së pasur të popullit të vet dhe të popujve të tjerë, shihet se me dëshirë është i mbajtur dhe gjithherë mbahet vetëm për thelbin. Prandaj, kundrimi i botës nuk është kundrim i një bredhësi, por i një udhëtari të menduar thellë për trekëndëshin: dje, sot, nesër.”

Tirana dhe Prishtina, ç’është ky raport, kjo tablo historie – ndërsa ju ishit adoleshent?

Prishtina dhe Tirana, para tunelit të Kalimashit dhe Rrugës së Kombit, për shqiptarët gjithmonë kanë qenë larg dhe afër. Edhe mua më ka mbajtur gjallë pamundësia për ta njohur veten. Vonë e mora vesh se nuk e kisha njohur sa duhet kombin tim. Gjatë kam besuar në gjëra të panjohura. Sa më thellë që futem në botën e artit, e panjohura më premtan një yll. Prandaj edhe unë jam nga ata krijues që ëndërrojnë, që i besojnë jetës. Me vite e vite, më shumë më mbante gjallë mashtrimi se pritja. Kur isha adoleshent, për gjëra të fshehura nuk e kuptoja kohën. Vonë, shumë vonë e kam kuptuar se nuk të çmend ngjyra e kuqe, por ironia me ngjyrën e kuqe.

Botimi i poezisë së parë më 1962 dhe ekspozita e parë më 1967: si kanë jetuar këto me njëra-tjetrën te ju?

Më 1962 në revistën letrare “Jeta e re” botova ciklin e poezive “Një ditë më vonë”, “Punë gjaku” dhe “Prapa diellit”:

*E pashë ma kapi Syri
E dëgjova veshi ma Kapi
S’më kapi mendja e Humba
Bora zuri borën.*


Bashkë me këto vargje dhe me poezitë e mia kanë lindur edhe pikturat e mia. Në ekspozitën time të parë më 1967, në Prishtinë, kishte portrete, fragmente, autoportrete. Humbësi i lumtur isha unë...

Ju keni botuar tashmë, të plotë, kompletin e veprave letrare prej nëntë veprash nga fusha e letërsisë. Çfarë është ky korpus që nis me “Humbësi i lumtur” (poezi) dhe mbyllet me “Ora me qyq” (ese)?

Kur ti je ti duke kërkuar vetveten, natyrisht që diçka lind e del në dritë. Kur i shoh Bjeshkët e Nemuna, syrin nuk ma mbush vetëm loja e ngjyrave. Sa më thellë që i futem botës, aq më mirë e shoh Yllin e Fatit. Tani, pas kaq shumë vjetësh, krijimtaria ime nuk është vetëm imja. Te “Humbësi i lumtur” për herë të parë jemi takuar. Te “Ora me qyq” veten e kemi parë sa larg e afër kemi shkuar.

Keni mbaruar studimet për pikturë në Beograd, ndërsa ktheheni në Kosovë në vitet gjashtëdhjetë duke përfaqësuar brezin që do ta përfaqësojë artin pamor në Kosovë. Çfarë atmosfere ishte, kujtimet që ju vijnë?

Gjatë viteve kur isha student në Beograd ëndërroja të pikturoja retë e bardha, oqeanin, detin... Të pikturosh një oqean nuk është çmenduri. Jo çmenduri, por dhembshuri. Është shumë e lehtë për ta kuptuar. Isha i ri. Shpesh ëndërroja se po fluturoja nga stacioni i trenit mbi Beograd, mbi hotel “Moska”, mbi pallat “Albania”, deri te Kalemegdani. Aty zbrisja. Afër ishte Fakulteti i Arteve, klasa ku unë ushtroja pikturën. Ato ëndrra tani më kanë lënë vetëm. Shkurtësia e





jetës është një kod. Për një lëvizje kulturore, atëherë Beogradi ishte 375 kilometra larg Prishtinës. Atëherë në Beograd profesorët i kisha nga shkolla europiane. Nga e njëjta shkollë ishin edhe shkrimtarët. Edhe elita kulturore e Beogradit. Gjatë atyre viteve edhe unë e pata fatin ta shoh një copë Europë: Pikason, Mironë, Xhakometin, Bekonin; të lexoj Xhojsin, Kafkën, Lorkën, Beketin, Preverin, Boskenë, Vasko Popën, Albert Kamynë. Shumë e rëndësishme ishte se isha i lirë dhe i vetëdijshëm se çka po kërkoj për ta vizatuar autoportretin tim.

Por ne, shqiptarët e Rrafshit të Kosovës, edhe pse hasmin e kishim mbi kokë, nga dritarja e vogël e pamë një copë Europë. Si Rilindje të dytë Kombëtare.

Në Prishtinë, shqiptarët filluan të japin atë që kishin, atë që dëshirojnë. Në gjuhën shqipe botohej gazeta "Rilindja", revista letrare "Jeta e re". Hapet universiteti. Arsimit dhe kultura filluan të shprehin vlerat e veta të para të një krijimtari moderne. Në fushën e arsimit e të kulturës shumë profesorë dhe krijues, me përkushtim dhe besim të plotë, e shprehën personalitetin e tyre si vlerë kombëtare.

Në këtë atmosferë mjaft të pasur kulturore, si keni arritur t'i kapërceni ndikimet dhe të keni gjuhën tuaj aq personale në pikturë?

Vit pas viti, o Zot i madh, kur në Beograd isha student, ëndërroja të isha balta e Tiranës. Isha i ri. Nuk e di a më kuptoni. Doja të isha balta e Tiranës. Atëherë në Tiranë nuk kishte baltë. Pa e njohur Tiranën, e doja më shumë se vetveten. Kur m'u dha rasti dhe leja ta shoh, nuk pata se ku të shkoj më larg. Isha i dashuruar me të. Duhet të më kuptoni. Kisha ardhur nga Prishtina

e nga Beogradi ku kisha studiuar pikturën. Gjatë atyre viteve valët e ëndrrave ku s'më çonin. Për pak harrova: si kam arritur t'i kapërcëj të gjitha ndikimet, as tani nuk e di. O Zot i madh, pse po flas për baltën e Tiranës. Rrezikoja. Doja ta jetoja jetën...

Rexhep Ferri

GABIME TË BUKURA

Ese



Onufri

Nga buron lënda, nxitja në pikturë?

Pak nga pak, më në fund, deti, oqeani, horizonti i hapur, ku çdo gjë më vjen nga heshtja e thellë, dëshmitari i vjetër, besimi dhe përkushtimi... Kur e përfundoj një vepër, më krijohet një ndjesi e mrekullueshme. Por, një ditë më vonë, më vjen ndjenja se ka mbetur pa ndonjë pyetje e pa ndonjë përgjigje. Natyrisht, pse-hu gjithmonë e ka një pse! Në faqe të malit.

Nga piktura në pikturë, përmes krijimtarisë letrare, cila ka qenë sfida më e madhe për ju? Çfarë ka mbetur nga Ferri, nga vetja?

Në moshë të re njeriu i ndjek xixëllonjat dhe shpesh sheh ëndrra. Dhe shpesh i mjafton vetëm vetvetja. Por kur vjen ndërrimi i shekullit, për askënd nuk është e lehtë. Për ta ruajtur drejtpeshimin si krijues. Gjithmonë duhet të jemi të vetëdijshëm se në çfarë sikleti e fusim veten dhe kjo ëndërr e ka një kohë të fshehtë.

Siç e shohim, i keni rënë një rrugë shumë të gjatë për të bërë krijimtarinë tuaj... Në çfarë keni besuar?

Njerëzit janë të prirur të flasin për ëndrrat e veta dhe për kohën e vet. Ishte e pabesueshme. Instinkti e mbijetesës e kisha të gjallë bashkë me ndjenjën e fisit krenar. Dhe nga dita në ditë, poezia ia merrte kohën pikturës. E mandej piktura ia merrte kohën poezisë. Dhe prapë e shoh se si vjen e kundërta. Sa mirë e kuptoja këtë ndjenjë. Në të e kam gjetur veten. Kjo është dhurata më e mirë që po marr nga jeta, që e kapa me gabime të vogla pa bërë gjëra të jashtëzakonshme.

Piktura juaj është vlerësuar për figurën e pastër, për kthjelltësi të thellë dhe perandorake. Dhe ajo që na tërheq, do të shtoja: e bardha e pikturës suaj, e bardha plot ngjyra - çfarë shënon te ju?

Nuk jam rritur me urrejtje. Pak e panatyrshme për ballkanasit. E Bukura e Dheut për mua është Bota. Ia kam kushtuar jetën. Edhe kur trembem nga ndonjë ëndërr, nuk largohem pa thënë diçka...

Më 1977 gazeta parisiane "Le Monde" shkruan për ju se: personazhet e heronjve pa gjysmë koke, me trupa të gjymtuar, të skematizuar, janë të mbërthyera dhe të mbuluara me ekzistencën e tyre (Miti për njeriun). Çfarë udhëtimi keni bërë? Ç'thyerje tabush kanë ndodhur?

Më 1977, në galerinë "Lambert" në Paris e hapa ekspozitën time me piktura e vizatime. Në gazetën "Le Monde", më 28 nëntor 1977, Jean-Marie Dunyer

Rexhep Ferri

ORA ME QYQE

Ese



Onufri

(Vijon nga faqja 3)

shkruan për ekspozitën time *Miti për njeriun*: “Ja, më në fund, një piktor që nuk i lëshon pe aspak publikut dhe i cili, duke iu përkulur thirrjes për kthjelltësi të thellë dhe perandorake, me gjithë rininë e tij paralajmëron një shpuputinë shembullore. Ai quhet Rexhep Ferri. Edhe më shumë se pikturat e tij, vizatimet e tij me tush krijojnë personazhe dhe masive malesh të shformuara e të zhveshura dhe gjithsesi, me një prani që të pushton... Ferri nuk flet kurrë për historinë derisa fytyra njerëzore i ka rezistuar prerjes së sëpatës, profilet e tij janë të tmerrshme, si çdo gjë nga një racë krenare.”

Ç’fuqi kishte shkrimi?

Arti nuk ka muskuj. Ka imagjinatë, besim dhe përkushtim. Kur flet deti dhe oqeani, dhe kur e përfundoj një vepër, më krijon një ndjesi, por edhe një zbrazësi për të thënë se asgjë tjetër s’kam për të thënë. Pas kësaj shkurtësie të mendjes, pas kalimit të ndonjë rruge, ndonjë ngjarjeje, na vjen diçka që na mbush dhe na e ndërron edhe mendjen.

Nga Kosova pyesim pareshtur për Esad Mekulin, Anton Pashkun, Azem Shkrelin, Ali Podrimjen... që janë monumente për kulturën dhe letërsinë. Ç’kujtime do të na sillnit nga këto njohje, ç’miqësi ishin? Në Tiranë u botua një prozë poetike për Agollin, kujtesë miqsh, por edhe shkrimtarësh, si ata njihen mes tyre...

Esad Mekuli me poezinë “O vlla me sharrë në krah” ka qenë kohanik me Migjenin. Migjenin në Shqipëri edhe lisat e maleve e njohin si poet. Sa për Esad Mekulin, në Shqipëri vetëm disa shkrimtarë e dinë se dikur në Rrafshin e Kosovës ka qenë njëfarë poeti i quajtur Esad Mekuli, që e mbante gjallë revistën letrare “Jeta e re”. Për Anton Pashkun, në Shqipëri, gjatë dyzet e pesë vjetëve kishte urdhër partie që të mos flitet për të si shkrimtar e as se është i gjallë. Për aq sa di unë, në Shqipëri janë disa shkrimtarë që Anton Pashkun e njohin vetëm si emër. Ç’do të thotë kjo? Pyeteni kufirin mes shqiptarëve. Tani mund të

them se është pak më mirë. Po nuk është e njëjta gjë. Përgjigjja është e thjeshtë. Po na pëlqen të jemi vetëm. Kujt t’ia themi se e kemi mirë. Ky realitet nuk është deklarata për shtyp, por dhimbje për vajin e burrit.

Ju më mirë se kushdo e njihni Ballkanin dhe shqiptarët – pse vazhdon të jetë tejet e vështirë marrëdhënia, së paku njohja, komunikimi me letërsinë dhe kulturën e njëri-tjetrit?

Për këtë pyetje që ma shtroni, nuk kam përgjigje. Kam vetëm pikëpyetje dhe pikëçuditje. Ju mund të më ndihmoni për ta kuptuar se kush jam e në ç’kohë po jetojmë. Ne shqiptarët shpesh kemi dhënë më shumë se ç’kishim. Po të ishte çdo gjë në rregull, sot do ta kishin Kadarenë nobelist për letërsi. Kjo është vetëm gjysma e zhgënjimit. Politika kulturore edhe tani po na qet në mal.

Kush do të na ndihmojë, e di vetëm djalli. Nga e panjohura pse kemi kaq shumë frikë. Ne andej në Kosovë po i mbyllim sytë. Ju këndeje në Shqipëri po i mbyllni sytë. Mesazhet mund t’i shohim vetëm në pasqyrën mashtrore. Nëse më pyetni pse, nuk e di.

Spartanët, për ta parë më mirë fëmijën nga gjendja shëndetësore, e kanë vlerësuar nga pamja e fytyrës. Shkurt e shqip ne e dimë çka mendon pasqyra për ne, por kurrë nuk e patëm guximin për ta thënë të vërtetën. Profeti ynë, Faik Konica, ka thënë: “Shqiptarët i bashkon vetëm rreziku.” O Zot i madh çfarë name na ka zënë!

Keni dorëshkrime?

Kam një problem. Ende po mësoj. Gjatë gjithë jetës po mësoj. Një e shkruar dhe një e ardhme bashkë. Pranë e pranë si frymë e deri kur. Kam vizatime, piktura, të nisura e të pakryera. Dhe, shumë ide të mira me të cilat shtrohet dreka. Po ashtu kam edhe skica e shënime të shkruara nëpër copëza të letrave e nëpër hapësira të zbrazëta të gazetave. Me këto provokime, shënime, pyetje, pikëpyetje, çka do të bëjë nesër nuk e kam unë në dorë. Natyra dhe jeta ku më çojnë nuk e di. Tani po më tërheqin vetëm gabimet e bukura...



DY FJALË SHQIP NË KROACI

Nga Azem Deliu

Ora 10.30 më gjeti në kafenenë ngjitur Shtëpisë së Shkrimtarëve, ku kam dhjetë ditë që kam mbërritur. Prej dy ditësh, ndonëse s’më kujtohet të kem lënë kurrfarë alarmi, gjumi më del saktësisht në 8.46. Iva, koordinatoreja e rezidencës, më ka lajmëruar që një e përditshme kroate ka shkruar për mua. “Very good, very good”, – thotë, gati me ton feste, mesazhi i saj. Palos librin “Para fundit” të Ernesto Sabatos, që e kisha lënë te letra e vitit 1949 nga Albert Kamy, dhe dal të blej gazetën. Nuk e di pse, me gjithë përmbajtjen dashamirëse, mendja më rri te fjalja e fundit e letrës së Kamysë: “Deri atëherë, llogaritni në simpatinë time vëllazërore.” Nëntë kuna, ma bën zonja e marketit duke më zgjatur gazetën. Rreth një euro e njëzet cent, domethënë. Në qytet më duket se të gjithë më buzëqeshin. I mpirë, i drejtohem kafenesë. Kamerierja më afrohet dhe pasi bëjmë të zakonshmet “Izvolite. Velika makiato”, tërhiqet. Të paktën çdo dy ditë, punoj me librin tim të radhës në këtë kafene.

Pak minuta më vonë më sjell kafënë dhe faturën mbi të cilën, pranë çmimit prej nëntë kunash që është fshirë me laps kimik, është shkruar me të mëdha GRATIS.

I çuditur nga moskuptimi i motivit, bëra me dorë ta thërrisja kamerieren. Kjo shenjë, pra t’i bësh kamerieres thirrje me dorë, gjykohej e paedukatë në Poloni, ku kam qenë vitin e shkruar. Në çast m’u kujtua ky “ligj” dhe mendimi se mund të mos jetë vetëm ligj polak, më bëri ta mbaj dorën për pak. Ndonëse e ula shpejt, kamerierja e kishte parë. Pa e pritur sqarimin, ajo mori gazetën e saj nga shanku dhe duke u afruar drejt meje, po kërkonte një artikull. E gjeti, ma nxori mbi tavolinë dhe preku fotografinë time. “This is why”, – tha ajo.


Shefi i saj, një shqiptar i shpërngulur prej të tetëdhjetave, e kishte lexuar artikullin për mua dhe kishte kërkuar që kafënë të ma shërbejnë pa pagesë. Kërkova ta takoj. Ai fliste një shqipe së cilës kontakti me gjuhën e huaj duket t’i kishte bërë veç dobi.

Kërkoi nga unë të pranoja që të më shërbenin falas nga një kafe në mëngjes. Refuzova dy herë. Insistoi tri herë. “Është e vështirë të shohësh gazetatat kroate të shkruajnë për një shqiptar”, – më tha. Më ngjante sikur entuziazmi i tij ishte më i madh se imi. Ndoshta ngaqë ai, për dallim prej meje, e kuptonte saktësisht ç’ishte shkruar.

Duke u përsëritur, mendja më shkoi përsëri te fjalja e Kamysë në letrën drejtuar Ernesto Sabatos.

“Deri atëherë, llogaritni në simpatinë time vëllazërore”.

Deri në fund të muajit, thashë me vete, një simpati vëllazërore do të më ofrojë kafënë. Mora librin, gazetën dhe pa u penduar që s’kisha punuar dot gjë, u nisa drejt rezidencës.



BOTOHET NË LONDËR NJË ANTOLOGJI E POEZISË BASHKËKOHORE SHQIPTARE

“Bantam” është një nga antologjitë e fundit poetike shqiptare redaktuar nga Elizabeth Wade (Melburn, Australi) dhe botuar nga Austin Macauley Publishing në Londër para pothuaj një muaji. Një antologji që nuk pretendon të jetë një antologji zyrtare që përmbledh poetët më në zë shqiptarë të kohës, pasi ka shumë autorë që nuk janë përfshirë, si Kadareja, Arapi etj., dhe kjo për arsye të ndryshme. Fatos Arapi nuk donte të përfaqësohej në asnjë antologji në të gjallë të vet. Po, poetët janë të shumtë, por çdo botues i huaj ka të drejtën për të bashkuar poetë që i lidhin ndjeshmëritë, stilet apo tematikat e njëjta. Pa dyshim që moria e shumë poetëve shqiptarë jep mundësinë e antologjive të tjera. Pra, poetika shqiptare është një minierë me profile të shumta “nëntokësore” dhe “mbitokësore”. Kemi të bëjmë me një përzgjedhje jo pretenduese të përkthyeses Miranda Shehu-Xhilaga dhe editores Wade, titulli i së cilës, “Bantam”, përfaqëson simbolikën e qelizës. Ishte dëshira për të dhënë diçka nga poezia shqipe, e shkruar njëherësh në kohë censure dhe më pas, në epokën entuziaste të ndryshimeve demokratike dhe të traumave të mëdha të zhgënjimit, kur liria dhe progresi kërcënoheshin nga autoritarizmi, “demo-kratura” e dhuna mbi liritë e fituara, nga korrupsioni dhe vështirësia e krijimit të një kulture të re proeuropiane, shtysa për të ndërmarrë një projekt të tillë. Ja çfarë shkruan me një dashuri të veçantë për poetët shqiptarë Elisabeth Wade në pasthënien e librit: “Ata që do të lexojnë këtë vëllim, do të pikasin një mori stilesh krijuese. Poeti është ai që lind poezinë, përkthyesja është mamia që e pret dhe unë ndoshta ajo që përkujdeset për këtë dhuratë të natyrës. Përkthyesit e këtij libri kanë pasur një detyrë të vështirë, gati të pamundur, të përkthejnë dhuntinë e plotë të poezive, shpesh komplekse dhe shumëplanëshe në një gjuhë të huaj. Megjithatë, përkthyesit duke qenë njohës të mirë të shqipes, i njohin domethëniet dhe thellësinë kulturore që nevojitet gjatë përkthimit. Jam e dashuruar pas fjalëve dhe poezia kërkon shumë nga këto fjalë. Fjalët mbartin një barrë të rëndë të dijeve, kuptimeve, të asonancës dhe qëllimit, shpeshherë të padukshme. Poeti shpërthen me fjalët e tij që lidhen me historinë, ndjesitë, mundësitë dhe fshehtësitë, që njëherësh janë të përbashkëta, por dhe thellësisht personale nga njëri te tjetri. Pimë të gjithë në të njëjtin burim, e megjithatë kemi shije të ndryshme, sepse në poezi fjalët kanë mundësinë e një shprehje të thellë, por dhe disi të fshehtë. Kjo është arsyeja çka bën të mbartim me vete një poezi që na pëlqen gjatë gjithë stinëve, gjatë gjithë jetës dhe e bën atë që të jehojë gjithnjë duke frymëzuar me idetë e saj. Disa prej tyre i dimë përmendësh, çka na ngushëllon, na lehtëson dhimbjet apo na jep kënaqësi në një ditë të zakonshme.”

Kjo antologji përfshin 17 autorë të kohëve dhe shprehive të ndryshme poetike, mes të cilëve edhe poetë, si Dritëro Agolli, Frederik Rreshpja, Ndoc Gjetja apo Koçi Petriti që kanë shkruar një vepër të rëndësishme poetike për të ardhmen, por dhe epitafë të jashtëzakonshme, si ato të Ndoc Gjetjes. Çdo poet përfaqësohet nga katër poezi, përmes të cilave çdo lexues arrin të njohë profile dhe ndjesi të veçanta, përfaqësuese, por dhe të një përkushtimi social të ditëve tona. Pjesa më e madhe e kësaj poezie e mbledhur nga Miranda Shehu-Xhilaga, aq e pasionuar pas poezisë dhe poete njëkohësisht, tregon se kjo letrare, përmes përkthimit të saj, ka arritur të japë maksimumin që

kanë dashur të thonë poetët në vargjet e tyre edhe pse, siç dihet, është e vështirë të gjesh një idiomë identike në një gjuhë tjetër që reflekton 100% atë të gjuhës origjinale në të cilën është perceptuar poezia. Kjo ndodh me të gjitha antologjitë, në të gjitha gjuhët, kur individët që ndërmarrin një projekt të tillë e bëjnë këtë thjesht nga pasioni dhe pothuaj pa asnjë shpërblim. Disa poetë të përfshirë në këtë antologji janë përshtatur në anglisht nga përkthyes të tjerë, si Ani Gjika, Henri Israeli, Robert Eslië, Sidorela Risto e Uk Buçpapaj.


Parathënien e kësaj antologjie Shehu-Xhilaga e nis me një varg të poetit rus Jevtushenko: “Poezia është një zog. Ajo nuk i njeh kufijtë.” Sigurisht, domethënëse për këto poezi shqiptare që kapërcejnë kufijtë e Ballkanit drejt kontinenteve të largëta. “Imagjinoni, - shkruan ajo, - një vend ku njerëzit lexojnë për të mbijetuar. Imagjinoni një vend ku njerëzit bëjnë ç’është e mundur për të gjetur një libër të ndaluar, thjesht për të hedhur një vështrim mbi botën jashtë. Është një vend ku talenti është i censuruar dhe i dënuar në atë mënyrë që një shkrimtar plot dhunti është i detyruar ta regjistrojë përmendësh krijimin e tij: po, një poet shqiptar i kësaj antologjie ka regjistruar në kujtesën e tij mbi njëqind poezi në burg. Megjithëse një nga diktaturat më të egra të Europës Lindore, ky vend do të na jepte gjenerata ëndërrimtarësh e poetësh që i këndojnë vendit të tyre, lirisë, dashurisë dhe një jete më të mirë. Lexuesi i kësaj antologjie të vogël do të gjejë aty imazhe që na kujtojnë hartën e bukur të Shqipërisë, të banorëve të tyre, të bukurisë dhe të betejave të saj. Dritëro Agolli është një udhëtar në një vend të shpresës së thyer, ku gjuha e Fasli Halitit mbart të zezën dhe ku pena e tij kërkon përgjigjet e një Zoti hipotetik, retorik e virtual që e ka humbur këtë tokë dhe ku vetë Zoti në kthim është i harruar. Është vendi i shtrenjtë i Ilirian Zhupës, i cili me gjithë bukurinë e tij, bën të fusë sytë e lodhur në xhepin e vet... dhe të marrë udhën drejt një ishulli të vetmuar, ku dritat, ngjyrat dhe zërat luajnë në mënyrë të natyrshme; vendi i Petrit Rukës, ku shkojmë nga

lufta në luftë dhe ku gratë janë gjithnjë shtatzëna me lëndën e parë të luftës. Dhe kështu Shqipëria e sotme te poezia e Luan Ramës është një lumë lotësh dhe një orgji e politikanëve të ndyrë, por megjithatë mbetet një ëndërr e shndritshme, një poezi e pambarimtë dhe një përrallë pasionante që na mban lidhur. Poetët shqiptarë të shekullit XX që paraqiten në këtë libër kanë përshkuar dy botë: njërën plotësisht të izoluar dhe të ashtuquajturën demokraci, që erdhi më pas. Nuk është e jashtëzakonshme të ndiesh dëshpërimin e poetit, pasi shumë prej tyre shkruajnë epitafë duke pyetur se ç’është një poet në një botë të tillë, duke pranuar të ikën nga kjo botë e të gjallëve. Pohimi i Ndoc Gjetjes sipas të cilit ai ka mbyllur qepallat dhe ka vendosur të shkojë, në Epitaf për vetveten, si dhe jeta e tij janë prekëse. Në poezinë e tij për një drejtësi sociale, Ah!, ai uron që gjithë njerëzit të jenë njerëz dhe të gjithë të jenë qenie njerëzore. Xhevahir Spahiu, në të njëjtën mënyrë e quan vendin parasë e ferrit duke deklaruar se ai ndihet i lirë veç kur është i dehur. Fjalët e Frederik Rreshpes janë pikëlluese. Por poetët, megjithatë, mbijetojnë edhe pse fluturojnë shumë pranë diellit. Poezia e Visar Zhitit, që është përkthyer nga i ndjeri Robert Elsie, është e jashtëzakonshme dhe ka forcën ta ndryshojë përfytyrimin tonë ndaj botës. Këta zëra poetikë këndojnë gjithashtu në rrethana të tilla për dashurinë dhe gëzimin, për atë ç’do të thotë të jesh poet, që të kapeshe pas jetës, pasi një ditë është shpirti njerëzor që do udhëheqë. Nga fjalët e ëmbla të Koçi Petritit, te vargjet shumëdimensionale të Petraq Ristos, duke kaluar në krijimet moderne të Visar Zhitit dhe Luan Ramës, ndjekur nga perspektiva e grave poete, poezitë e dashurisë në këtë libër e lënë lexuesin të uritur për më shumë. Arian Leka kompletion këtë qark me prurjet e tij bashkëkohore mbi dashurinë dhe jetën e qytetit të tij bregdetar.

Fill pas ndryshimeve politike, në poezinë shqiptare të viteve ’90, midis shumë poetëve shqiptarë, nga më të rëndësishmit që u shfaqën ishin gra. Poeteshat në këtë antologji të tronditin dhe të ngërthejnë me shkrimin e tyre të shkathët dhe modern. E njohur si mbretëresha e poezisë, Natasha Lako, një nga të parat poetesha të gjeneratës së saj, tregon se çfarë ndodh kur ndërgjegjja femërore zgjohet. Ajo nuk mjaftohet të shohë se çfarë ndodh mbi dashurinë e mohuar, dashurinë e keqtrajtuar, dashurinë e keqinterpretuar. Poezia e saj sociale u bën apel të gjithë atyre që duan ta mishërojnë gjithçka ka një shpirt dhe të gjithë ata që mbajnë për këpucë kafshët e vrara. Luljeta Leshanaku, një imazhist e njohur botërisht, na ofron peizazhe të një bukurie dhe vrazhdësie të pamatë: një ekzistencë humane gjysmëshekullore në gropëzën e një dore. Një poete provokuese, Rita Petro, i paraqet lexuesit një botë të sajën, ku shtjellon origjinën e dashurisë dhe të seksit. Mendimtare e pavarur dhe vëzhguese sociale, Mimoza Ahmeti propozon diskutimin e perceptimeve të ndryshme dhe kërkon më shumë refleksion për ndryshimet që do duhej të ndodhin. Poezia shqiptare e viteve ’90 e më pas është thellësisht bashkëkohore. Shkruar në vargje të lira në një formë të shkurtër dhe koncize, kjo poezi i tregon lexuesit të përditshmen e vet dhe gjithashtu ndryshimet sociale, duke shkuar krah poezisë europiane dhe botërore.

Poeteshat shqiptare Natasha Lako, Luljeta Leshanaku, Mimoza Ahmeti dhe Rita Petro e kanë pasuruar këtë kurorë e pa dyshim, në antologji të tjera, në një afresk akoma më shumëngjyrësh, do të na shfaqen profile të tjera. Është një dukuri e veçantë e letërsisë shqipe shtimi i autoreve femra në dhjetëvjeçarën e fundit dhe kjo jo vetëm në numër. Zëri i tyre i ka dhënë poezisë shqipe një frymë shumë më humane. Vargjet e tyre nuk janë thjesht vargje dashurie, por thirrje të forta për ndryshime të mëdha shoqërore në qendër të të cilave është vetë gruaja, ajo grua në gjithë dimensionet e saj, ku pleksen gjeneza, mëmësia, feminiteti, inteligjenca, forca, dëshira e ripërtëritjes, është ajo grua që kërkon ta ndryshojë këtë realitet, për t’i dhënë shoqërisë së sotme një humanizëm të ri në shërbim të progresit njerëzor...

L. R



Dy parathënie të autorit shkruar për versionin e veprës së tij të plotë më 2009 dhe ribotimin, si libër më vete, në vitin 2015 të sprovës “Uragani i ndërprerë: Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe”

ISMAIL KADARE:

ËSHTË E DREJTË E ÇDO AUTORI TË ZGJEDHË VERSIONIN QË I DIKTON NDËRGJEGJJA E TIJ



Sprova për Migjenin, e titulluar fillimisht “Uragani i ndërprerë”, u shkrua si parathënie e gjerë për botimin e veprës “Novelat e qytetit të Veriut”, në Francë, në fund të viteve tetëdhjetë. Meqenëse me tekstet e botimeve të veprave të letërsisë shqipe në gjuhë të huaja merrej shtëpia e botimeve politike “8 Nëntori”, përkthimi në frëngjisht, si dhe miratimi i tekstit, nuk mund të bëhej veçse prej saj. Sprova për Migjenin kaloi kështu nëpërmjet një shtëpie botuese që shquhej për dogmatizmin e saj të skajshëm. Kjo ka kushtëzuar ndoshta edhe më fort një pjesë të kufizimeve të këtij teksti, që gjithsesi ishte vështirë të shmangeshin.

Ndërkaq, duhet thënë se me datën e botimit të kësaj sprove është kryer, me dashje ose pa dashje, një

dezinformim publik, i cili për herë të parë po sqarohet në këtë shënim.

Sipas marrëveshjes me shtëpinë botuese franceze “Fayard”, proza e përkthyer e Migjenit, bashkë me sprovën e gjerë që e shoqëronte, u dorëzua në fillim të vitit 1989. Pak kohë më pas, libri doli nga shtypi në Paris. Teksti i sprovës nuk u botua në shqip dhe as u paraqit prej autorit në ndonjë shtëpi botuese.

Një vit pas ikjes së autorit në Francë, teksti i sprovës, i mbetur në zyrat e shtëpisë botuese “8 Nëntori”, u botua prej kësaj shtëpie pa kurrfarë leje të autorit, pa asnjë sqarim dhe jashtë çdo mbikëqyrjeje të tij. Redaktori i botimit, siç e dëshmon botimi, ka qenë Arshin Xhezo, kryeredaktor i gazetës më politike shqiptare, “Zëri i popullit”.

Data e botimit, 1991, pas rënies së komunizmit, për një temë delikate për nga natyra e saj, të shkruar më 1988-1989, siç është shënuar në fund të tekstit, pra në komunizëm, do të krijonte, pa dyshim, jo pak habi midis lexuesve. Thelbi i çështjes lidhej me pyetjen se si ishte e mundur që kjo trajtesë, e botuar pas rënies së komunizmit, nuk kishte as më të voglin sqarim për ato kufizime, një pjesë e të cilave diktoheshin madje dhunshëm prej rendit komunist, siç ishte problemi i klerit katolik dhe sidomos i Gjergj Fishtës. Për këtë është folur gjerësisht në intervistën në “Hyllin e Dritës”, që ribotohet në këtë vëllim të veprave.

Sprova për Migjenin ishte një rast për t’i dhënë publikut të gjerë francez një tablo të përgjithshme të letërsisë shqipe që nga zanafilla e gjer në kohën tonë. Kufizimet e tekstit, gjuha shpeshherë e ngurtë, epitetet e ashpra “reaksonar, shovinist, arkaik, konservator”, të përdorura me tepri, shpeshherë për të lehtësuar kalimin e ideve dhe mesazheve liberale, nuk do ta dëmtonin aq rëndshëm tablonë në sytë e publikut francez, sa ç’do ta dëmtonte

heshtja e plotë dhe mospërmendja e emrave të ndaluar, në radhë të parë e emrit të Gjergj Fishtës. Për publikun perëndimor epiteti “reaksonar” nuk kishte atë ngjyrim tragjik si te ne, ku përfytyrimi i parë shoqërues ishte skuadra e pushkatimit. Në tekst ishin trajtuar në një mënyrë pothuajse normale shkrimtarë të ndaluar ose gjysmë të ndaluar, si: Konica, Koliqi, Pasko, Poradeci. Mbetej gjithmonë Gjergj Fishta i cili, ashtu si i dënuari numër një, që s’mund të shfaqet në publik pa prangat në duar, nuk mund të përmendej pa epitetet shoqëruese të zakonshme, çka ishte ndoshta më mirë sesa të mbetej në terr të plotë.

Aty-këtu në tekst ka ndonjë përpjekje të druajtur për ta ndryshuar gjuhën ndaj Fishtës, si në kreun pesë, ku flitej për nacionalizmin antisllav të poetit: “Aq më pak nuk i lejohej një poeti që, duke dhënë tablo tronditëse të kësaj ndeshjeje dhe duke u revoltuar me të drejtë ndaj padrejtësive që i qenë bërë e vazhdonin t’i bëheshin kombit shqiptar, të mos bënte, megjithatë, një dallim midis popujve sllavë e shovinizmit serbomadh.”

Ka gjasë të jetë hera e parë që në Shqipërinë komuniste shprehja “duke u revoltuar me të drejtë” të jetë përdorur për Fishtën.

Në të njëjtin kapitull, pak radhë më poshtë, thuhet se mesazhet shoviniste nuk pranoheshin në Shqipëri, “qoftë edhe kur ato parashtroheshin nga një poet i shpallur kombëtar, e qoftë të shprehura me një poetikë hijerëndë e mjeshtërore, siç qe përmbledhja ‘Mrizi i zanave’, vepra më e arrirë artistikisht e tij”.

Siç shihet, është një përpjekje, ndonëse ende e brishtë, drejt normalitetit. Po t’i shtohet kësaj edhe ikonografia e botimit francez, ku fotografitë e Fishtës, ashtu dhe të shkrimtarëve të tjerë të ndaluar, zënë vendin e tyre të natyrshëm midis plejadës së shkrimtarëve të mëdhenj të kombit, atëherë mund të thuhet se një përpjekje e parë, ndonëse e pamjaftueshme, është bërë drejt rehabilitimit.

Dosja e Gjergj Fishtës vazhdon të mbetet e hapur në Shqipëri. Dhe kjo është e kuptueshme. Borxhi ndaj tij mbetet gjithmonë i madh, më i madhi borxh ndaj një poeti i ndërgjegjes shqiptare. Ky borxh mund të lehtësohet dhe do të lehtësohet vetëm me dashuri dhe sinqeritet, dhe jo me nervozizëm dhe revansh. Për fat të keq, janë këto dy të fundit që ende ndihen më fort. Dhe është e natyrshme të jetë kështu, përderisa shpeshherë qëllon që në ballë të falangës për kinse mbrojtjen e poetit, shfaqen shpesh fytyra jo fort të besueshme. Është thënë dhe duhet përsëritur prapë se nuk mund ta mbrojnë poetin rrahagjoksët që gjer dje nuk ia përmendnin kurrë emrin, as disidentët e rremë, që kanë shërbyer në policinë e fshehtë komuniste, që kanë denoncuar e futur në burg kolegët, as ata që shquhen ende sot për nostalgjinë ndaj otomanëve, ose



që afishohen kundër Gjergj Kastriotit.

Mospërputhja midis adhurimit ndaj Gjergj Fishtës dhe njëfarë shpërfilljeje që ende vazhdon është kushtëzuar ndoshta nga ajo që u tha më lart. Dëshmi e kësaj shpërfilljeje është përrurimi tejet modest dhe gati-gati i bojkotuar i shtatores madhështore të poetit, vepër e skulptorit të shquar Ilmi Kasemi. Shtatorja e poetit e dyzuar nga transfiguracioni në bronz i poezisë së tij epike u përrurua në Lezhë, më 15 gusht 2009, në kohën që po shkruheshin këto radhë. Ajo që duhej të ishte një festë kombëtare e artit, shoqëruar me një ndjenjë të thellë meditimi për shkrimtarët e ndaluar, kaloi për habi si një ngjarje e rëndomtë, gati-gati e pavërejtur nga media dhe nga krejt shoqëria shqiptare.

Bojkoti i shtatores nxori në pah se veçimi i poetit vazhdonte në Shqipëri, njëzet vjet pas rënies së komunizmit, për të tjera arsye tani dhe nga të tjerë faktorë. Nuk ishin të paktë ithtarët e poetit që, me dashje ose pa dashje, në vend që të shmangnin pengesat dhe moskuptimin, shpeshherë i shtonin ato. Krijohesh përshtypja se s'bëhej asnjë përpjekje për të afruar drejt Gjergj Fishtës njerëz që, për arsye që dihen, nuk e njihnin atë, ose që mendimin e gabuar për të dëshironin ta qortonin. U krijua kështu, dashur padashur, një brez sanitar rreth poetit, pra një veçim i ri, pikërisht atëherë kur duhej të ndodhte e kundërta.

Një tjetër mungesë e kësaj sprove për Migjenin është trajtimi i figurës së mbretit Zog. Ndonëse shteti komunist kishte një linjë të përcaktuar rreptë lidhur me këtë personazh, mund të thuhet, pa frikë, se censura për Fishtën ishte dukshëm më e pakapërcyeshme se ajo për mbretin. Rrjedhimisht, sado paradoksale të duket, për shtetin komunist shqiptar poeti Gjergj Fishta ishte më i rrezikshëm se mbreti Zog.

U theksua kjo për të vënë në dukje se përmendja e monarkut të parë shqiptar në këtë parathënie kurrsesi nuk ishte aq e vështirë sa e Fishtës, kështu që as epitetet e vrazhda ndaj tij nuk ishin as të detyrueshme dhe as të përligjura. Arsyeja e ashpërsisë ndaj mbretit lidhet me tjetër gjë dhe pikërisht me një nga motivet kryesore të kësaj sprove, marrëdhëniet midis sunduesit diktator dhe shkrimtarit të madh. Në kohën që u shkrua kjo sprovë dukej qartë se ky raport të kujtonte më shumë rendin komunist, sesa shtetin mbretëror. Për rrjedhojë, paralelizmi i hamendësuar midis diktatorit komunist dhe mbretit, vetvetiu e dëmtonte kryesisht këtë të fundit.

Një tjetër problem delikat që, në një mënyrë ose në një tjetër, shtrohet në këtë trajtesë, është raporti midis Migjenit dhe shkrimtarëve të mëdhenj të ndaluar, kryesisht Fishtës. Ky raport as është shtruar e as që mund të shtrohet drejt. Sipas një tradite të keqe të ideologjisë sunduese të kohës, Migjeni cilësohej gati-gati si pararendës i realizmit socialist shqiptar, çka ishte një mashtrim i pashembullt. E keqja vazhdoi më pas, kur, në vend që ky mashtrim, bashkë me komunizmin, të rrëzohej, ai vazhdoi të mbrohej, këtë herë nga kampi kundërshtar, nga vetë fishteanët. Migjeni vazhdoi të quhej shkrimtar pothuajse komunist, ndonëse të gjithë e dinin se kjo nuk ishte e vërtetë dhe se mentorin e tij i parë kishte qenë pikërisht Ernest Koliqi, i shquar për antikomunizmin e tij.

Pas viteve '90, në kohën e demokracisë, kundër Migjenit, kinse në emër të antikomunizmit, u përdor dhe ende vazhdon të përdoret një gjuhë mizore, që nuk i lë asgjë mangët traditës staliniste.

Kësaj tradite iu shtua zakoni i keq shqiptar, sipas të cilit rikthimi në Panteonin e letrave i një shkrimtari të madh, shoqërohej nga dëbimi prej Panteonit i një tjetri shkrimtari të madh. Kështu u vunë në skajimin më të mbrapshtë të mundur Fishta me Migjenin, thua se nuk mund të rrinin të dy atje ku të dy e kishin vendin në këtë botë: pikërisht në Panteon.

Historia e trishtë, e bashkë me të keqkuptimi dramatik, ende vazhdon në kohën e ribotimit, pas njëzet vjetësh të kësaj sprove.

Tiranë, fundverë 2009

SQARIM PËR BOTIMIN SI LIBËR MË VETE (2015)

Ky është sqarimi i dytë, pas atij që ka shoqëruar botimin e kësaj sprove në serinë e "Veprës së plotë" të autorit në vitin 2009. Siç është përmendur në shënimin e parë, tekste të tilla problematike kanë shtruar, dashur padashur, një alternativë paradoksale, për të mos thënë jo fort të logjikshme. Thelbi i saj lidhej me pyetjen: ç'do të bëhej me tekste të tilla të krijuara në një rend të vështirë ku liria e shprehjes nuk njihej? Do të botoheshin më pas, ashtu siç ishin shkruar, pa kurrfarë ndryshimi, apo do të lejohej njëfarë retushimi minimalist, natyrisht i shpallur prej autorit?

Me fjalë të tjera, mbi këto tekste do të rëndonte njëri nga dy dënime: të mbartnin përgjithmonë vëlën e së keqes apo, për të shmangur këtë, të mos botoheshin më, thënë ndryshe, të shuheshin përgjithmonë?

Çështja e retusheve është shoqëruar me spekulime, nisur nga më banalet, siç është data e krijimit të veprës, gjer te natyra e retushit.

Të sqarimi i vitit 2009 – çështja themelore është ajo e datës. Në pamje të parë ngjante e thjeshtë dhe në thelb, është e tillë. Nuk ka gjë më të vërtetueshme në botë sesa koha e krijimit të një veprë. Megjithatë, në një vend ku spekulimi kthehet në modë, guximi i spekulantëve nuk njeh kufi. Ndaj dhe sqarime që në rrethana normale s'do të ishin të nevojshme, bëhen të tilla.

Në kushtet e ndërrimit dramatik të rendit politik, kur flitet për retushet, është fjala në radhë të parë për ato të natyrës politike. Retushet e tjera janë pjesë e procesit normal të krijimit në çdo kohë e në çdo vend.

Kjo marrëveshje për termat është e domosdoshme për të ndërprerë çdo abuzim. Një tjetër domosdoshmëri është shpallja prej autorit e çdo retushimi, bashkë me përgjegjësinë morale që ai merr për të.

Domosdoshmëria e tretë, ndër më themeloret, është saktësimi i qartë se në këtë çështje është fjala kryesisht për vepra studimore, sprovë e shpalime panoramike, dhe kurrsesi për krijime të mirëfillta artistike. Retushimet për romane apo drama, ku pas rrëzimit të komunizmit personazhet komuniste kthehen në antikomuniste dhe

e kundërta, nuk janë veçse sajesa të humorit të kafeneve dhe s'ka pse të merren seriozisht prej askujt.

Për t'u kthyer te pyetja se ç'do të bëhet me krijimet eseistike tek të cilat, pavarësisht seriozitetit, dëshmohen haptas gjurmët shtrënguese të kohës ose kufizimet e vetë autorit, zgjidhja e problemit nuk është e pamundur. Qortimi i një mendimi, ndreqja, plotësimi apo riformulimi i një vizioni, qoftë edhe në rastet delikate, kur arsyet janë politike, janë të njohura.

Për tekste të tilla, alternativa, ose të botohen ashtu siç kanë qenë, pa as më të paktën ndreqje, ose të zhduken nga faqe e dheut, vështirë se mund t'i qëndrojë logjikës normale. Në rastin e zgjidhjes së dytë, asaj të zhdukjes, vetvetiu do të shtrohej pyetja: në emër të kujt do të bëhej kjo? Për t'i bërë një nderim të tërthortë epokës që u përmbys? Për të pranuar, gjithmonë tërthorazi, një triumf të mbrapshtë karikaturesk të saj? Me fjalë të tjera, për të mbrojtur si të përjetshme gabimet e diktura prej saj?

Është e drejtë e çdo autori të zgjedhë versionin që i dikton ndërgjegjja e tij. Aq më tepër për vepra që botohen pa lejen e tij, siç ndodh shpesh në hapësirën shqiptare në Ballkan.

Si përfundim, mund të thuhet se përvoja botërore na mëson që, pa qenë kurrsesi i njëjti proces me retushet artistike, ndreqja e gabimeve në procesin e studimeve eseistike, pavarësisht shkakut të zanafillës, është pjesë e zhvillimit dhe emancipimit kulturor.

Kjo e drejtë e autorit, pjesë themelore e së drejtës universale, nuk mund të preket nga askush dhe në asnjë rrethanë. Është autori që e ka bërë gabimin, është ai që e shpall publikisht atë dhe është përsëri ai dhe askush tjetër, që përpiqet ta ndreqë.

Këty parimi i përmbahet ky botim i fundit i sprovës për Migjenin. Siç ndodh shpesh në raste të tilla, ky nuk është kurrsesi një rishikim i plotë i tekstit. Përkundrazi, retushet janë tepër të rralla e të kursyera. Si të tilla ato janë të pamjaftueshme për të shmangur keqkuptimet. Janë heqje radhësh dhe paragrafesh dhe asnjëherë shtesë. Ndër dhjetë kapitujt e kësaj sprove, retushe (heqje radhësh) kanë vetëm dy prej tyre: i pesti dhe i gjashti, gjithsej rreth dyzet radhë. Pjesa tjetër e tekstit është e njëjta me atë të vitit 1989.

Ismail Kadare, verë 2015



VAJZAT E TRANZICIONIT

Nga Ervin Hatibi

HYRJE

pjesëmarrje vullnetare
e fytyrave nëpër
dekore qytetare
faqe që përtërihen
faqe vajzash, fasada dekadash
që përhihen në
fizarmonikime
kolibrore
ditarësh
të një
(dy, tre, katër, pesë...)
adoleshence
me afat të parashikuar skadence

(AGENDA)

të hapësh derën, të mbyllësh derën
të presësh me syze dielli verën
të ndërrosh parfumin
dekorin
kostumin
të bësh maksimumin
të përdorësh telekomandën
të shtypësh tetën
dyshin
gjashtën
të kujdesesh për tonin kur ngre telefonin
-të dielën votonin
të zhysësh kartonin
për një emër
mashkull a femër-si herën tjetër
të ndërrosh fenë, ndoshta dhe seksin
të gjesh pretekstin

(BREAKING NEWS) (BBCNN)

prapë luftë dhe prapë
makinat
e refugjatëve nën avionë
kanë targat perse të
Afganistanit

mjekë pa kufij
të parruar
tymosin
jashtë vdekjes pop të Bob Marlit

(CHORUS)

kinezë, francezë, senegalezë
hieroglif me bojë kine të zezë
njëlloj të gjithë ndryshe ngjajmë
po na shpove njëlloj na del gjak
dhe kokakola
në xhinse gri na del boja
dhe e njëjtë është jehona
pop që lëshojnë fort rrugët tona
(por edhe aroma)
e njëjtë fytyra
përsëritet rruar nëpër pasqyra
si a-të e rrumbullakëta
në fundet e vakëta
të emrave italianë
të grave
të fqinjëve tanë
(me rimë)

THIRRORE KORRIDORI

Goca t'buk'ra të rinisë sime të parë
Për ju më hapen e më bien përduarsh
Freskoret kineze të enumeracionit
Me ju hapen e mbyllen afresket
Përgjithësisht bardhezi
Të arkivave të tranzicionit
“...Sonila Sopi u gjet e therur
Në Milano, në plehra e hedhur”
Gocat e buk'ra të rinisë sime të parë
Ju ishit pa e ditur dhe pa faj
Bija të luleve të San Franciskos oqeanike
Por shampot ju vinin nga Bullgaria
False dhe ballkanike
Ju vetëm liri, liri kërkonit
Dhe mëshirë nga motoristët e palarë të Babroit
Goca të mira të Tiranës së parë
Burrat tuaj janë reporterët italianë
E ju më dukeshit të gjitha të mira
Kurse unë isha thjesht i pakrehur
Dhe nuk kam pasur kurrë Sida
Thjesht më pëlqenin legjendat dhe Stigma
Si kafshë shtëpiake, por e egësuar
Ju vrojtoja
Përtej Bob Marlit biond të flokëve të mi
Goca të mira, të njohura, të Tiranës së natës
Me zhargonin tuaj të zhdukur tashmë
Bashkë me baret efemere
Në Jug t'Unazës
Bashkë me pseudonimet romantike të spaçatorëve të
Vjetër
Që në fakt e nxirrnin bukën
Me ndonjë zanat tjetër
Zhdukur zërat tuaj si mente në mitingun e opozitës
Që zgjaste sa besimi ndaj politikës
Zhdukur përfundimisht silueta juaj e mirë
Nëpër palestra
Ku sot fabrikojnë një tip femrash të tjera
(pak më të lehta)

*Shënim: Cikël i marrë nga vëllimi “Pasqyra e Lëndës”,
shtëpia botuese “Ora”, 2004*



REQUIEM PËR TIRANËN

Nga Bardhyl Londo

MËNGJESI NË KUKËS

Ditën që u vendos në Kukës busti i martirit Havzi Nela

Mëngjesi vjen në Kukës
Me një diell që nuk di ç'të bëjë:
Të qeshë apo të qajë.

Mëngjesi vjen në Kukës
Me një Drin epik
që ende s'e di është i bardhë apo i zi.

Mëngjesi vjen në Kukës
Dhe kurrë s'e mori vesh
përse është më i pikëlluar se Pikëllima.

Mëngjesi vjen në Kukës
Dhe qyteti kurrë nuk e kuptoi
Është qytet i vjetër apo qytet i ri.

Mëngjesi vjen në Kukës
me dy lumenj që lidhen si një nyjë
dhe kurrë s'e morën vesh
a janë një fjongo delikate në kokën e një vajze
apo janë një fjongo e zezë për një kurorë funerali.

Mëngjesi vjen në Kukës
mes Gjallicës, Pikëllimës dhe Kortnikut si në një
trekëndësh gjigant
lëkundet trupi i varur i Havzi Nelës.

Kokën në qiell, këmbët në tokë
dhe askush s'e di
kujt i flet më shumë, qiellit apo tokës.

Dielli lind në Kukës me fytyrën e Havzi Nelës,
trupi i tij varur në trekëndëshin e tri maleve,
kurmi i tij shtrënguar në nyjën e dy lumenjve,
një lajmës i përjetshëm midis qiellit dhe tokës.

Herë i jep tokës sinjale me këmbë,
herë mesazhe i kumton qiellit me dy duart e ngritura
lart.

Mëngjesi vjen në Kukës me Havzi Nelën
ndërmjetës midis qiellit dhe tokës.

Qershor, 2018

PASIONI

Nata jeton me pasionin e agimit,
e sotmja ëndërron të nesërmen.
Vetë hapi i njeriut mbi tokën time -
trajektore e pasioneve të ndershme.
Nga pasione të bukura, njerëzore,
lindin, vdesin, rilindin miliona dashuri.

Do të vdes nga pasioni për të qenë njeri.

1988

NOSTALGJI

E mora në duar kokën tënde,
prushi i gjakut pëllëmbët m'i dogji.
Në sytë e tu si në një ëndërr rashë
dhe më s'u zgjova.

Në sytë e bukur si loti.

Me gishtat e dridhur të dashurisë
emrin tënd shkërmoqa garmë për garmë.
Të thirra e dashur,
Të thirra motër,
Të thirra nënë.

Ti hesht, e bukur, e tejdukshme,
natyrshëm siç mbin bari.
Oh, hapi ata sytë e zes,
hapi, të vijë
behari.

Hapi ata sy
më përrallorë se fantazia e Zhyl Vernit,
dy lëndina ku rritet lirizmi.
Në retinën e tyre si në ekranin më të ndershëm
Veten më mirë kuptova,
ty,
njerëzimin.

Je tepër e lashtë për të të thirrur Evë,
je tepër e bukur për të të thënë Zhuljetë.
Sa kohë kemi që duhemi? Dy mijë, tri mijë vjet?
Me ty e kam lindur Prometeun,
me ty shekullin e njëzetë.

Po ty
të zuri gjumi?
Shtrihu.
Ti më mësove të vërtetën e madhe:
DASHURIA ËSHTË NJË MONUMENT
MBROHET NGA NJERIU!

ATDHEU ËSHTË DHIMBJE

Atdheu s'është sa sedilja e makinës tënde,
sa karrigia e zyrës,
sa dhoma komode.
A më dëgjon?!

Ti që me flamur të ri u gdhive në mëngjes,
për ta ndryshuar ndoshta
prapë në mbrëmje.

Atdheu s'është lojë kalamajsh.
Atdheu është dhimbje.

O Zot,
Dhimbje!

URA DHE BRIGJET

Ne jemi si dy brigje të një lumi,
përjetë përballë, përjetë të ndarë,
natën ndërtojmë në ëndrra një urë,
ditën mbetemi të huaj si më parë.

Ne jemi si dy brigje të një lumi,
(Fat të rëndë paskan, e dashur, brigjet!)
Në ëndrra qajmë e qeshin bashkë,
ditën të flas, ti s'më përgjigjesh.

Dhe në mos më pafsh një ditë në vendin tim,
përballë teje në mos më pafsh një natë,
mos u beso fjalëve që thonë të kam harruar
besomë mua: jam shndërruar në Rozafë.

Një urë të ngre të lidhen brigjet,
me ditët e mia, me ëndrrat do ta mbaj,
të vij të mbështes kokën mbi supin tënd
dhe të hesht, të qesh, të qaj.



Më 11 mars 1981 në Kosovë shpërthyen demonstratat e fuqishme. Pavarësisht territ informativ, ne në Tiranë e kishim zemrën dhe mendjen në Prishtinë. Për fat të keq, censura zyrtare na kishte ndaluar të shkruanim për ta, madje edhe t'u përmendnim emrin. Atëherë gjeta një mundësi tjetër: shkrova poemën "Vajzë e vogël me jetë të madhe", një poemë kundër dhunës, por pa e përcaktuar vendin, që u botua në revistën "Nëntori". Në dy këngët e fundit, të cilat po i postoj pa asnjë ndryshim, vertikalisht gërmat e para të çdo vargu lexojnë Kosovë dhe Prishtinë.



KAQ PRANVERA

Kaq pranvera kanë ardhur dhe ikur,
O pranvera s'pyeska për asnjë tank.
Si shami nëne të ulet mbi varr një re bjeshke,
O klith një stuhi që larg.
Vjen një shqipe e bukur me krahë të pushton,
Është vallë shqipe apo zemra jonë?



LIRI

Po pyetët ju që vini: ç'u bë tanku i mallkuar,
Rrotat lubi ju kanë ëndërruar edhe ju,
Ishte një tank thotë koha, po s'është më
Shndërrimi në rërë, stacioni i fundit i tij.
Ti ke mbetur vajzë e vogël, e bukur siç ishe,
Ishte një vajzë, ishte një tokë dhe janë përsëri,
Në doni të mësoni emrin e saj
Është i thjeshtë: Liri...

Pranverë, 1981

Leximi i poezisë/ Poezia rri symbyllë para diellit. Mbrapa janë lutjet gojëlangëta të mbrëmjes, gojën lëng nga dëshira a nga vaji i zotave dhe mandej goditja me drapër e metaforës: "për tana herët që s'i je dhanë qiellit t'territ tue ia zhgulë pemët" – Kjo është një metaforë shumë vizive dhe e fuqishme, shkulja e pemëve qiellit të territ

LEXIMI I POEZISË "MJESEVE MUNDESH ME BA SENDE ME DRITËN" TË LEDIA DUSHIT

Nga Entela Tabaku

*Mjeseve mundesh me ba sende me dritën
me iu ruejt me ba sy e sy e sy për me e gjejt
mos me marrë frymë mjeseve tue kërkuje gjumin gjithkah
mjeseve mundesh me i shtri një kah një lutjet gojëlangëta
t' mbramjes
t'Zotave t'ngulun t'zhgrehun n'vaj për Lutjen n'kambë
për tana herët që s'i je dhanë qiellit t'territ tue ia zhgulë
pemët
mjeseve mundesh edhe mos me u lutë ma mbas diellit që
t'ban për lojë
e t'prish për gjumë tue pa ara e ara e ara t'lame n'ar me
drapna e drapna e drapna t'zhdrukun*

Leximi i parë (leximi i sipërfaqes)

Poezia dhe lexuesi kanë nevojë të takohen disa herë për t'u njohur. Si takimet e dashurisë. Nëse pas takimit të parë nuk ke më dëshirë të rikthehesh, atëherë e di se nuk bënte për ty. Në çdo takim mëson dhe ndien diçka të re për poezinë dhe për veten. Sa më thellë të mund t'i hysh një poezie, sa më thellë gërmon ajo në ty, aq më e mirë është ajo. Për ty, si lexues. Në këtë perspektivë, leximi i parë është gjithmonë një lexim i së dukshmes, i sipërfaqes: tema (për çfarë flet poezia) dhe gjuha poetike (çfarë e mban një poezi në këmbë figurativisht, cilat janë metaforat, gjetjet, ritmi). Në leximin e parë vëren edhe si të bën të ndihesh kjo poezi. A të hyn në gjak, a të flet ty apo ta kundron botën me sytë e tjetërkujt. Nëse pas këtij leximi i ke thënë të gjitha, atëherë e di se kjo poezi ishte e këndshme. Kaq. Kurse poezia e mirë të rikthen te vetja gjithmonë. Asaj nuk mund t'i ikësh, ashtu si nuk mund t'i ikësh vetes. Kjo është ndër poezitë që duhet të përgatitesh ta lexosh disa herë, disa herë, disa herë. Se është ndër ato poezi që të buzëqesh në fillim e të këndon në vesh që në leximet e para. Dhe ti si lexues mundesh me u shtrij i kënaqur, duke u përkundë në atë melodi që përçohet në sipërfaqe. Dhe mendon se kaq ishte, kjo qe poezia. Por mos u dorëzo kaq lehtë! Ja po ta them që në fillim, Ledia Dushi nuk shkruan kurrë për lexues që kënaqen kollaj. Portat e parajsës poetike të saj janë të fshehura në bërthamën e fjalës. Janë si ato ilaçet e mbështjella me kapsulë, i fut në gojë dhe ndien vetëm shijen sipërfaqësore të mbështjelljes. Disa nga ju mund edhe të thonë: Oh sa e ëmbël! Hahaha, duhet ta gëlltitësh, i dashur lexues, ta lejosh të përzihet me lëngjet e stomakut tënd, të të shkrihet në gjak.

Por le ta shohim pak sipërfaqen: Një poezi e zgjimit. Shumë fjalë e sinjalizojnë temën, ai çasti i zgjimit, loja midis diellit dhe territ, mjesit dhe mbrëmjes, ai çasti kapërcyell: syhapë a symbyllë? Çasti i palëvizshmërisë. Kohëzgjatja është disasekondëshe, ndoshta. Por që në sipërfaqe ndihet rrjedha, apo jo? Të parat që e sinjalizojnë që në këtë lexim janë përsëritjet: rimarrjet vertikale "mjeseve mundesh" dhe rimarrjet horizontale "sy e sy e sy", "drapna e drapna e drapna". Përsëritjet krijojnë, nga njëra anë, ndjesinë e rrjedhës së çasteve që shkojnë pashmangshëm drejt zgjimit dhe nga ana tjetër, ndjesinë e marramendjes dhe përthumbjes së sapozgjimit. Se kush

është i qartë në ato momente. Poezia rri symbyllë para diellit. Mbrapa janë lutjet "gojëlangëta" të mbrëmjes, gojën lëng nga dëshira a nga vaji i zotave dhe mandej goditja me drapër e metaforës: *për tana herët që s'i je dhanë qiellit t'territ tue ia zhgulë pemët*.

Kjo është një metaforë shumë vizive dhe e fuqishme, shkulja e pemëve qiellit të territ, që krijon një kontrast shumë interesant me atë gjendjen e pafuqishme të parazgjimit. Të krijon idenë e një fuqie si ato që kemi në ëndrra që, për një arsye a një tjetër, s'mund të realizohen. E ndien se do të mundje të vrapoje një maratonë po s'lëviz dot as këmbën. Poezia rri symbyllë para diellit. Mbrapa është gjumi i humbur. Gjumi i pagjumësisë së mosdhënies ndajterrit. Tash hapi sytë dhe merr frymë!

Leximi i dytë (leximi i teknikës)

Leximi i dytë zakonisht nis e t'i zbulon sekretet e realizimit, është leximi i teknikës. Shumica e poezive nuk kanë sekrete, kanë vetëm metafora. Por talenti i vërtetë nuk qëndron në metaforat. Mendja e njeriut është një prehër i pafund metaforash. Talenti i vërtetë qëndron në krijimin, shpesh spontan, të një ndërthurjeje metaforash, gjendjesh dhe emocioneve që e rishpikin poezinë në mendjen e lexuesit. Lexuesi e gjen veten duke zërthyer teknikën e poezisë njëkohësisht që zërthen veten. Në këtë pikë poezia duhet lexuar me zë të lartë:

A e lexove? Lexoje edhe një herë, është krejt e shkurtër. A e ndien rrjedhën?

Kjo është poezi e rrjedhës. Nga ato që krijojnë gjendje me fjalë që nguten njëra pas tjetres pa pika dhe presje, pa thyerje të logjikshme vargjes, veçse turrje përpara drejt fundit që nuk është një ujëvarë e rrezikshme, por veçse një prag i ri rrjedhe që nuk mundesh me iu shmangë.

Një mënyrë e tillë të shkruari e ka një efekt anësor: të lë pa frymë. Fizikisht dhe metaforikisht. Ja, lexoje këtë varg: *e t'prish për gjumë tue pa ara e ara e ara t'lame n'ar me drapna e drapna e drapna t'zhdrukun*.

Lexoje me zë të lartë. A e ndien si jeton me frymën tënde dhe se si, kur mbaron, është i mbushur me frymën tënde, ndërsa ty të duhet me u mbushë me frymë të re? Dhe nuk është gjatësia, sepse po të ishte kështu çdo varg i gjatë do na linte pa frymë. Por është



një forcë e brendshme e vargut që e josh frymën dhe nuk e lë të ikë pa i shkruar në fund. Një fenomen i tillë quhet edhe talent, me fjalë të tjera. Mendoje se si një moment kaq i paqetë dhe i palëvizshëm në dukje, ajo kohë kur po të del gjumi, transmetohet me një vrull të tillë të brendshëm. Ëmbëlsia e leximit të parë të shtyn të mendosh se po noton këndshëm një mëngjes të bukur në liqenin e Shkodrës. Ah, bile ndokush kthehet në shpinë dhe pluskon duke iu kënaqur diellit! Ah, por këtu i thonë Drin. Dhe në Dri nuk notohet, Drini të merr me vete dhe të nxjerr aty ku do vetë. Ndërkohë, poezia rri palëvizshëm në diell, me sy të mbyllur. Ajo çfarë të ndodh ty si lexues është efekti i saj, është ajo shtresa e nëndheshme që lëviz padukshëm. Ti mendon se është dielli që luan me gjumin, por, në fakt, është poetja që luan me ty dhe me leximin tënd. Ajo është zonjë përmbi gjuhën. Ku shkel ajo, e vendos gjurmën e saj mbi domethënien e fjalëve: *mundesh me ba sende me dritën*.

Poezia na mëson se sende munden me qenë gjithçka që i shkon asaj në mendje, jo veç çka pret ti si lexues se sendet mund të jenë. Ku shkon ajo ndryshon ritmi i vargut dhe nëse ti ke arritur t'ia dëgjosh hapin, veç shpejton t'i dalësh përpara ara ara ara ara ara.

Leximi i tretë (leximi i mendimit)

Poezia e mirë e shtyn lexuesin pashmangshëm në një lexim të tretë, leximin e mendimit. Sepse poezia nuk është vetëm teknikë dhe fjalë. Poezia është mendim. Poetët e talentuar mbjellin mendime dhe përjetime në ne. Leximi i tretë e ndihmon lexuesin të ndjekë fillin e mendimit të poetit dhe fillin e mendimit të vet. Zgjimi është një çast shumë fatal. E gjithë dita përcaktohet nga ai moment i shkurtër i parazgjimit, ai moment peshues kur gjithçka vihet në provë: A dua të zgjohem? A dua të rikthehem në jetë? A kam fuqi të zgjohem? A kam fuqi të rikthehem në jetë? A duhet të zgjohem? A duhet të rikthehem në jetë?

Është i vetmi moment kur mund ta përjetojmë pa pasoja të qëndrueshme (d.m.th. vdekjeprurëse) atë lojën midis vdekjes dhe jetës. Në gjumë jemi të vdekur, por të vdekur për t'u ringjallur. Qelizat rigjenerohen. Por, njëkohësisht, edhe prehemi. Jeta na jep pak orë pushim nga çmenduria e përditshme që kërkon kaq shumë nga trupat tanë të mjerë, që veç shkojnë duke u harxhuar dhe konsumuar. Çdo mëngjes është një mëngjes më pak. Vdekja e vërtetë ndodhet një mëngjes më tej. Por është edhe një mëngjes më shumë për t'u përballuar. Dhe një shtytje e brendshme na thotë: Prehu tash! Pusho! Harro! Prandaj disa orë para zgjimit çlirohet në trup hormoni i kortizonit, që e përgatit trupin për zgjimin shumë kohë para se të jetë ora e zgjimit. Kjo sepse duhet një forcë e madhe jo vetëm psikologjike, por edhe kimike, për ta përballuar këtë shkëputje nga vdekja e gjumit. Duhet një forcë gati mbinjerëzore për ta zgjedhur me dëshirë luftën e jetës. Ti zgjedh. Mjeseve mundesh me u lutë ose mos me u lutë.

Leximi i katërt (leximi i vetes)

Në leximin e katërt lexuesi e njeh mirë poezinë, tashmë. Nëse ka mbërritur deri këtu, e do këtë poezi, e dashuron. Për temën, gjuhën poetike, për mjeshtërinë e realizimit, për fillin e mendimit, por sidomos sepse në leximin e katërt ka për ta ndier poezinë deri në fund, ka për t'ia ndier dehjen, magjinë, do të jetë a thua se e ka shkruar vetë. Leximi i katërt është leximi i vet. I shtrëngoj sytë fort në diellin e mëngjesit. Bota mbushet me ngjyra të papara. Një mrekulli. Këto janë vetëm ngjyrat e mia. Askush s'mundet t'i shohë, përveç meje. Unë mund t'ua tregoj, t'ua përshkruaj, por ata munden veç t'i përfytyrojnë. Dhe t'i lexojnë *drapna drapna drapna drapna drapna drapna të zhdrukun*.

Me rastin e 99-vjetorit të tij, u përrua në teatrin "Migjeni", Shkodër, përmbledhja poetike "Perfectum Trinum", me poezi të zgjedhura nga Montale, Quasimodo, Ungaretti

ZEF ZORBA DHE NJË TRINI POETËSH

Nga Suadela Balliu

"Omne Trium perfectum!" - thotë shprehja latine që e sheh përsosmërinë në gjithë ç'vjen në trini. Ashtu siç i ka parë edhe poeti Zef Zorba tre hermetikët e mëdhenj italianë, të cilëve u shqipëroi poezi dhe bashkë me to, edhe shënime mbi jetën, veprën dhe tiparet dalluese të secilit. "Por ai është këmba e katërt e kësaj platforme moderniste, që bën bashkë dy brigje të poezisë", - thotë Ana Shkreli, nga botimet "Çabej", që sapo ka sjellë të botuar përzgjedhjen poetike të titulluar "Perfectum Trinum".

*Fill vetëm në gji të dheut çdonjëri
Prej një rrezeje dielli sheshtuar
E bëhet muzg menjëherë (Quasimodo)*

Ishte viti 1984, disa vjet përpara se të ndihej vërtet agonia e diktaturës, ndërsa poeti dhe përkthyesi nga Shkodra, përkthente në fshetësi letërsinë e ndaluar. I shkolluar në Padova, në vitet '40 tre poetët italianë ishin edhe të parapëlqyerit e tij. "Kjo antologji është e pamjaftueshme për pasqyrimin e veprës poetike të tre apo për paralelizmin e tyre pasi, veç së vërtetës "traduttore-traditore", edhe vetë metoda e


antologjizmes është, dashtë e pa dashtë, vullnet i përzgjedhësit dhe njëfarë shkruandjeje e veprës totale të autorit", - shkruante tridhjetë e pesë vjet më parë shqipëruesi i cili, mjerisht, asnjë nga veprat e përkthyer apo krijimtarinë origjinale të tij nuk do ta shihnin dritën e botimit sa që ballë.

*Një parmak flladi
Për të mbështetur sonte
Trishtimin tim (Ungaretti)*

"Nga fraksionarizimi ka rrezik që "poeti njeri" të paraqitet me refleks jo të qenësishme nga e gjithë prodhimtaria e tij. E mbarsa do të ishte të jepej shqipërimi i plotë i veprës poetike të çdonjërit. Po kujt ia mban? Mua jo", - shkruante Zorba, me rigorozitetin thuajse shkencor të shqipëruetit, me vetëdijen se do të vinte një ditë që puna e tij do të botohej dhe do të njihej nga lexuesit. Eugenio Montale, fitues i Nobelit të letërsisë më 1975, Salvatore Quasimodo, Nobel i letërsisë më 1955, Giuseppe Ungaretti, i kandiduar po atë vit dhe Zef Zorba, poeti i sirtarëve apo hermetikëve dhe modernisti i cili do të njihej nga lexuesi shqiptar vetëm pas vdekjes, kur më 1994 do të botohej vepra e tij poetike "Buza e ngrirë në gaz". E megjithatë, edhe shumë vjet pas vdekjes, atë e mban gjallë i gjithë korpusi letrar, dorëshkrime që presin ende ta shohin dritën e botimeve. Një zotim i të bijave kur ai u nda nga jeta dhe që në këtë 99-vjetor të tij përrua në teatrin "Migjeni", në Shkodër, përmbledhjen poetike "Perfectum Trinum", ndërsa thonë se kanë gati të tjera dorëshkrime, që do të botohen deri në 100-vjetorin e tij.

*Më dukej një lodër e lehtë
Ta bëja asgjë largësinë
Që më qe hapur të këmbëja
mëzinë
E zbehtë me zjarrin tënd të
vërtetë (Montale)*

Zef Zorba mund të quhet, pa dyshim, një artist i plotë dhe i shumanshëm: poet, përkthyes, publicist, regjisor, autor pjesësh dramatike dhe libretesh. Lindi në Kotorr më 1920, në një familje shqiptare. Më 1941 u regjistrua në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, në Universitetin e Padovës, por u detyrua të ndërpriste studimet më 1943 për shkak



të Luftës së Dytë Botërore dhe të kthehej në Shkodër, ku jetoi deri në fund të jetës, më 1993.

Ende sot shumë përkthime të tij mbeten në sirtar, në dorëshkrime; T.S. Elliot me "Katër Quartete", "Pritje koktej", "E mërkura e përhimë", poema të Robert Frost, Oscar Wilde, me "Rëndësia e Seriozitetit", si dhe vepra nga Pirandello, Wilder, O'Neal etj. Si regjisor në Shtëpinë e Kulturës në Shkodër, pati vënë shfaqje në skenë, si "Armiku i Popullit" i Ibsen-it dhe "Juda Makabe" të Fishtës. Ndoshta kjo ishte edhe arsyeja pse u burgos më 1946, për vjet me radhë.

Zorba kapërceu kufijtë e krijimit mirëfilli letrar dhe eksploroj pikëtakimin e letërsisë me muzikën apo artet pamore, duke i shtuar korpusit të tij artistik edhe dy librete operash, "Teuta" dhe "Rozafa", tekste këngësh me muzikë të Prenk Jakovës, por edhe punime gdhendjesh në dru, të cilat ilustrojnë poezinë antike greke, tragjedinë dhe komedinë klasike.

Librat e tre poetëve italianë Zorba nuk i shihnte si një përmbledhje e thjeshtë poezish, por një vepër e plotë, në vështrimin e mirëfillt aristotelian. Për librin e tij "Allegria" Giuseppe Ungaretti thotë: "Ky libër s'është veçse një ditar. Autori nuk ka ndonjë ambicie tjetër dhe beson se edhe poetët e mëdhenj s'kanë pasur pikësnyim të ndryshëm, pos që të linin një biografi të bukur të vetën." Prandaj edhe librat e tyre mbajnë që në titull këtë karakteristikë ditari, mendon Zorba. "Përpos parametrave të përbashkët, këta tre poetë kanë veçori krejt individuale, sidomos në shpalosjen e botës poetike të secilit, guxoj të them se vepra e tyre, duke mbetur subjektive, është njëheri komplementare e prodhimtarisë së njëri-tjetrit, duke pasqyruar kështu një sistem qiellor unik, me veçori të pandryshueshme individuale, por harmonike në mes tyre e sidomos pa errësuar njëri-tjetrin".

Më 2019 Zorba i sjell lexuesit shqiptar rreth 100 poezi të tre poetëve italianë të shekullit XX. Botuesja e "Çabej", Brikena Çabej, ka zbuluar se fare pak ndryshime iu bënë tekstit origjinal gjatë redaktimit. "Gjatë punës që bëmë me tekstin, disa dyshime fillestare për ndonjë lapsus që na pati shtyrë të ndërhyjmë në tekst, në fund i lamë mënjane, duke menduar se shqipëruesi ishte larguar me kast nga origjinali dhe i kishte dhënë vetes liri për licencë poetike. Mendimin e parë për t'i korrigjuar ato pak raste e ndryshuam në çastin e fundit dhe i kthyem tekstet siç i kishte në dorëshkrim shqipëruesi". Botuesi italian "Mondadori" dha leje për botimin e kësaj përzgjedhjeje me kushtin për të vendosur përbri edhe tekstet origjinale italisht, në një botim dygjuhësh.

Montale Quasimodo Ungaretti Perfectum trinum

poezi të zgjedhura
me tekstin italisht përbri



ÇABEJ

Javën që shkoi është themeluar në Shkodër Muzeu i Kulturës Françeskane, një projekt i prezantuar nga arkitekti Gjon Radovani, që përfshin praninë 800-vjeçare françeskane në Shqipëri, shoqëruar me ekspozitën e parë të piktorit Lin Delija

SI E RIKRIJONTE BOTËN NË ART PIKTORI LIN DELIJA

Nga Ardian Ndreca


Lin Delija e nisi rrugëtimin e tij artistik në klostrin françeskan në Shkodër, ku shpirti i tij prej artisti nuk kishte ra në një tokë djerrë, mbasi arti dhe kultura mburshin vetvetijshëm jetën e atij mjedisi. Muzika, piktura, skulptura, poezia, teatri ishin frymëmarrja e atij oazi drite që mendohej me formue të ardhmen e Shqipërisë.

Rrethanat historike në të cilat u përshkue jeta e tij dhe fati deshtën që në vitin 1954, i sapoardhun në Romë, Lin Delija të takojë me Ernest Koliqin, i cili do ta ndihmonte në hapat e parë tue i gjetë një bursë studimi në Akademinë e Arteve të Bukura.

Atmosfera romane, njohja me rrethet ma në zâ të pikturës së viteve '50-'60 dhe sidomos primja kah arti i shenjtë (it. *arte sacra*) banë që veprat e tija të mbusheshin me vedrime shenjtësh e martirësh shqiptarë, me skena plojash që komunizmi po bante mbi popullin e pafajshëm. Lin Delija ka pikzue tragjedinë e një kombi e i ka dhanë ngjyrë dënësës së nanave e motrave që vëjshin për bijtë e vëlleznit e vramë, të burgosun, të internuem apo të detyruem si ai me braktisë atdheun.

Në pikturat e tij shndritë gjithnjë një dritë shprese, figurat ma shpresëdhënëse janë ato që prihen me u stërzgjatë drejt qiellit, tue kalue horizontin e dhimbjeve e të territ, të lëshueme kah një dritë e epërme hyjnore.

Në artin e vet Lin Delija ka interpretue botën në dy përmasat e saja thelbsore: të shenjtën dhe tokësoren. Tokësorja shkëlqen në figurat rinore, përdërdhet me tingujt e një jete të lumtun e plot laryshí – kjo asht pjesa që ai ka përjetue në botën e lirë. Por ka edhe një realitet tjetër tokësor që zen vendin ma kryesor në shpirtin e tij. Ai përbahet prej kujtimeve vetiake dhe prej rrëfimeve të atyne që kishin ikë prej atdheut.



Nepërmjet tyne vijnë deri tek ai lotët, plagët, jeta e burgjeve, kumtet për mësuesat e shokët e pushkatuem, mundimet e një populli e të një Kishe heroike. Dikund në një syzë rafti artisti ka ruejt deri në fund të jetës zhgunin e tij të viteve të kolegjit. Shpirtin e ka pasë të thurun me fjet e ashpra të atij zhguni të lyem me gjak martirësh. Prej atij gjaku ai andrronte shëlbimin e një kombi të shtypun e të nepërkambun.

Vepra e tij asht si kumti i një të mire të vonueme e shumë të dëshirueme. Ngjyrat e tija ruejnë freski në tonet e ndezuna dhe shprehin vucjten e madhe shpirtnore në hijet e randa që përvijohen në fytyra, lëvizje, peizazhe e qiej të randuem me dhimba të pathanshme.

Shkruente për të Ernest Koliqi: “Mënyra piksuese fare origjinale e Lin Delis tërheq sidomos për reflektimin e një vegimi të botës ku shfaqen krejt pikpamjet e rrënjësuna në tharme thjeshtësisht e thellësisht shqiptare: një botëkuptim, në të cilin vlojnë prirjet mâtipike të Shqiptarit të kulluet, të mertisuna me ngjyra plot fuqí shprehëse. (...) Ai veshë me magjín mâtë lulzueshme të ngjyrave tipa njerzorë dhe pamje jete të kapërthyeme në një tragjicitet ndiesish.”

Mbas shumë dekadash Lin Delija po kthehet rishtas në atdhe me artin e tij, i cili asht dëshmitar i një shpirti të pastër dhe të bukur, i një dashunije të gjatë që e përcolli deri në kufijtë e amshimit.

Lin Delija kthen artin e shenjtë në gjinin e pikturës shqiptare, ku ky lloj arti pothuejse mungonte qysh prej kohës së Onufrit.

Përshpirtnia dhe ndjesia e së përtejshmes (*transhendentales*) bajnë që ai me gjuhën e zgjedhun të ngjyrave të sjelli sot mallin për një t'ardhme që asht, por ende s'ka ardhë tek ne dhe nderimin për një të kalueme të dhimbshme që s'duhet harrue kurrë.

Delija i ndejt larg qarqeve të industrisë kulturore italiane, shikoi me mosbesim modat e momentit dhe primjet me përfitue prej politikës. Përveç artit të shenjtë ai trajtoi me shumë pasion edhe nudot, në paraqitjen e të cilave tregoi se zotnonte teknikat e traditës ma të mirë të shkollave figurative, pati ndikimet e pikturës venedikase, ato të ekspresionistave francezë dhe të shkollës romane të shek. XX.

Format e kolme, shikimet e ambla, paqa e trupave që dijnë me drejtue dëshirat nëpërmjet një gradacioni kromatik që i shkrin me peizazhin, aftësia me shkue edhe përtej tue trajtue karakteret – bajnë që Delija të mbesin një za i përveçëm i pikturës së shek. XX. Nudot e Delisë paraqesin shejtninë e trupit njerzor me një lirizëm prekës. Erotikja e tij nuk asht asnjherë vulgare, por mbërrin me elektrizue kanovacën tue instaurue një dialog piktoresk me trupin.

Në qendër të artit të tij pati njerzoren që e shprehu me vibracione kromatike të rralla, tue parapëlqy si subjekt nudot femnore, dinamikat e trupit, labirintin e dëshirave që komunikojnë jetën dhe vullnetin me u njohtë. Bahet fjalë për figura të çmueshme, të sofistikueme, shpeshherë të papërfundueme si vetë dëshirat që e kanë frymzue artistin përgjatë jetës së tij.



Te Delija ndërthuret kthjelltësia dhe zymtsia, efektet ndriçuese marrin hov prej pranisë së territ, raportet tonale dhe sprovat kromatike shpeshherë janë origjinale dhe bazohen në gjendjen shpirtnore, por edhe në momentet e jetueme. Asht thanë tashma prej zanave me autoritet se piktura e tij të kujton vetvetijshëm Daumier, Degas, Toulouse-Lautrec, Manet edhe pse qëndron përtej post-impresionizmit.

Mes qiellit dhe tokës përshkohet kompozime masive kur domethaniet shtresëzohen dhe sensit figurativ i rrin hijshëm përkrah përdorimi jokonvencional i ngjyrave, gjithnjë pa ba që Delija të jetë një kolorist i randomtë. Mund të themi se Delija e ri-krijon realitetin, siç ban çdo artist i vërtetë, tue e trajtue në terapinë intensive të artit për me arritë me kundruekështu spektaklin e jetës pa u ba rob i realizmit objektiv. Nganjherë tek ai ndeshim deformime groteske, stilizime të

MUZEU I KULTURËS FRANÇESKANE, PRANIA 800-VJEÇARE NË SHQIPËRI

Provincia françeskane “Zoja Nunciatë” e Shqipërisë dhe e Malit të Zi, së bashku me shoqatën kulturore “Art Union Albania”, kanë organizuar (më 11 prill) në mjediset e provincës françeskane në Shkodër ceremoninë e prezantimit të projektit të Muzeut të Kulturës Françeskane në Shkodër si dhe të themelimit të muzeut “Lin Delija” përmes dhurimit të mbi 100 punëve të piktorit nga ana e shoqatës “Art Union Albania”. Ceremonia, e drejtuar nga provinciali i Urdhrit Françeskan, Atë Aurel Gjerka, u përshëndet nga Nunci Apostoli në Tiranë, imzot Charles John Brown dhe ministrja e Kulturës, znj. Elva Margariti, në prani të të ftuarve të shumtë nga të gjitha përfaqësitë fetare në vend, trupi diplomatik, akademikë e studiues, artistë e qytetarë të Shkodrës. Në fjalën e tij të hapjes provinciali Atë Aurel Gjerka vlerësoi përpjekjet e përbashkëta që çuan në këtë moment të rëndësishëm themelimi, duke theksuar vetëdijen e përhershme të françeskanëve shqiptarë se historia e urdhrit të tyre ka qenë dhe mbetet e pandarë nga historia e Shqipërisë.

Muzeu i ardhshëm Françeskan do të jetë në

AL «MARGUTTONE»

Lin Delija: neorealismo tra verità e coerenza

Erano molti anni che il pittore Delija mancava dall'ambiente artistico romano: pochi sapevano dove stava, come viveva, e qual'era la sua arte da quando scelse un paese del Reatino per lavorare in pace, fuori dal frastuono della città e dalle beghe di cerchia.

Poi improvvisamente si seppe che era fra i partecipanti alla mostra di arte Sacra in Vaticano: esponenti grossi nomi nazionali ed esteri. Fra questi primeggiavano Guttuso, Cagli, Vespignani... e Delija.

La sua profonda convinzione religiosa, l'onestà umana che lo caratterizza si riscontrano nei suoi lavori, tutti soffusi di tenera poesia che tende sempre ad evidenziare stati di animo improntati alla serenità e alla bellezza delle cose semplici.

Allievo di Mafai e Bartoli, da questi ha appreso il senso del colore e la tessitura della rappresentazione, mentre l'estro e la forza creativa Lin se l'è portata dentro di sé fin



Lin Delija: «Al vespro».

getti ritratti, cogliendo nel contrasto un valore che di un post-impressionismo cromaticamente «povero»,

«suoi» paesani quegli uomini all'osteria, quelle donne scarnificate che pregano inginocchiate di traverso sulle balaustrate della «sua» chiesa e quei fazzolettoni acconocchiati dietro la nuca di vecchie sull'uscio ad ammazzare il tempo, i bambini e mille altre cose, sono Delija.

In fondo è la stessa Albania aspra che si riscontra nelle opere di Lin e che idealmente qui la rivive a diretto contatto con la gente di tutti i giorni, quella stessa che anima le stradine medievali del borgo e che ha a strapiombo, sulla sua magra agricoltura, l'ombra e la minaccia di monte Giano, quasi a barriera un'impensabile fuga.

Delija è un interprete scrupoloso di ogni sentimento umano e riesce a vitalizzare ogni sfumatura della vita, degli uomini, fissando particolari momenti che trascendono il significato per assurgere a monito e preciso insegnamento.

Ogni sua opera diventa significante nella realtà rappresentativa, desumen-

dukshme, hiperbolizime të gjendjeve shpirtnore dhe errësime e ikje nga figura, e gjithë kjo i shërben idesë së artistit vizionar me shkue përtej, tue rrezikue edhe dëshpërimin, por gjithnji i mbajtur gjallë prej besimit dhe forcës shpirtnore.

Lin Delija në tentativën e tij të parë me u kthye në atdhe si piktor nuk u kuptue dhe madje u pengue prej xhelozinave provinciale, arti i tij jokonvencional dhe i

panjoftun për një vend ku kishte mbizotnue realizmi socialist nuk pranohej as në ambientet e tija dhe kjo gja bani që ai të kalonte nga kjo jetë i zhgënjyem. Sot ai meriton një vend të denjë në qytetin e tij të lindjes. Nëse ky i fundit mton ende me i thanë vedit “djep kulture”, duhet që djepi të mos mbesin shkretë, pse kultura asht ushqim jetik dhe jo diçka që i përket së kaluemes që nuk asht ma.

çdo rast një hapësirë e vogël, por e çmuar, sipas ideatorëve, për të strehuar këtë trashëgimi të shumanshme që françeskanët shqiptarë dhe kolegji i tyre i mirënjohur krijuan, kultivuan, mblodhën e përpunuan me përkushtim shembullor. Hapësirat e këtij muzeu do të jenë vendtakimi i brezave të sotëm e të ardhshëm me poetë, dramaturgë e përkthyes, si Leonardo de Martino, Gjergj Fishta, Vinçenc Prennushi; me prozatorë brilante, si Fishta e Anton Harapi; me etnografë e antropologë të kulturës, si Shtjefën Gjeçovi, Bernardin Palaj, Donat Kurti; me historianë, si Marin Sirdani; gjuhëtarë e stilistë, si Benedikt Dema e Justin Rrota; filozofë, si Gjon Shllaku; muzikantë mjeshtërorë, si Martin Gjoka dhe me personalitetin e rrallë të françeskanit të

paharrueshëm Atë Zef Pllumit, vepra memuaristike e të cilit vijon t'i kërkojë shoqërisë shqiptare përballjen etike me të shkuarën e saj komuniste. Këtë mision ka edhe ky muze. Ai do të jetë, ndër të tjera, dëshmia reale e humbjes së rëndë që pësoi kultura dhe dija kombëtare prej asgjësimit të veprave dhe të autorëve të tyre. Në përshëndetjen e saj, ministrja Margariti vlerësoi iniciativën dhe premtoi një mbështetje reale dhe institucionale për zhvillimin e mëtejshëm të këtij projekti me vlerë e rëndësi jo vetëm për Shkodrën, por për të gjithë kombin. Ceremonia vijoi me kumtesat e studiuesve, si: Atë Flavio Cavallini i cili prezantoi “etapat historike të pranisë françeskane në Shqipëri”, prof. dr. Persida Asllani që paraqiti konceptin mbi “rrëfim muzeor të kontributit kulturor të françeskanëve shqiptarë”, si dhe prof. dr. Ardian Ndreci i cili trajtoi në kumtesën e tij modalitetet “e rikrijimit të botës në art piktori Lin Delija”. Ndërsa arkitekti Gjon Radovani, projektuesi i Muzeut të Kulturës Françeskane, prezantoi konceptin arkitekturor jo vetëm të këtij muzeu, por edhe të rehabilitimit të tërësisë së hapësirës së Kuvendit Françeskan në Gjuhadol, në funksion të kujtesës kombëtare, por edhe të turizmit kulturor në qytetin e Shkodrës. Gjatë ceremonisë, të pranishmit shijuan koralet e korit “Atë Martin Gjoka” të Kishës së Shën Françeskut – Gjuhadol, nën drejtimin e mjeshtër Zef Çoba, shoqëruar nga kuinteti për harqe i Universitetit të Arteve.



BOTIMI

Revista “Jeta e re” në Kosovë, për letërsinë dhe kritikën

Sapo ka dalë në qarkullim numri i ri i revistës letrare të traditës “Jeta e re”, i pari për këtë vit. Të shtatë rubrikat e këtij numri sjellin autorë me peshë nga fusha e letërsisë, teorisë dhe kritikës letrare botërore dhe asaj shqiptare. Revista hapet me ligjëratën e shkrimtarit dhe studiuesit të letërsisë, Sabri Hamitit, me titullin “Mësimi i letërsisë”, mbajtur në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Rubrika e prozës nis me tregimin “Përralla e ishullit të panjohur” të nobelistit Jose Saramago, për të vazhduar me “Në pritje” të shkrimtarit, gjithashtu shumë të njohur, Amos Oz, me tregimet e shkrimtarit, publicistit dhe dramaturgut argjentinas Roberto Alt: “Shkak dhe marrëzi xhelozie”, “Vëmendje beqari”, “Zilja e ndrojtur”, “Njeriu që gjithmonë të jep të drejtë” dhe “Fjalimi që do të kishte sukses”, pastaj me tregimet e shkurtra “Dreka e Pashkëve” dhe “Pesë minuta” të shkrimtarit italian Paolo Zardi. Nga autorët tanë, Rahman Paçarizi është prezantuar me tregimin me titullin “Helena ime”, Virion Graçi me “Takime në mesnatë” dhe “Xhojsi në fotografi”, dhe Gazmend Bërjalolli me “Fëllanza”.

Rubrika e poezisë nis me një cikël të gjerë poezish të poetit dhe dramaturgut të njohur spanjoll, Garsia Lorkës, për të vazhduar me poetin amerikan Lingston Hughes, me poemën “Komesari Magreli” të poetit italian Varello Magreli. Ndërkaq, nga autorët tanë me nga një cikël poezish në këtë numër të revistës janë paraqitur Ibrahim Berisha, Osman Gashi, Skënder Zogaj, Arif Kutleshi dhe Përparim Blakaj, ndërkaq me një intervistë me titullin “Pas çdo fjale fshihet një botë e tërë” vjen shkrimtari Heinrich Boll. Në rubrikën qendrore të revistës “Dossier”, në një hapësirë prej 50 faqesh, vjen Eugene Guillevic, një nga poetët madhorë të poezisë franceze të kohës, i përkthyer në më shumë se pesëdhjetë gjuhë të botës. Rubrika nis me një tekst të shkurtër vlerësues të Andre Velter-it me titullin “Guillevic”, për të vazhduar me një cikël të gjerë poetik të këtij autori, përzgjedhur nga disa libra të tij. Rubrika përfundon me tekstin interesant dhe me interes autobiografik “Të jetosh në poezi”.

Në rubrikën e kritikës janë prezantuar një numër autorësh tanë dhe të huaj. Rubrika nis me tekstin e David Perkins-it “Kontekstualizmi historik” dhe vazhdon me “Gramatika e krijimit” të George Steiner-it, njërit ndër kulturologët më të mëdhenj sot, me “Pamundësia e përkthimit të Franc Kafkës” të shkrimtares së shquar amerikane Cynthia Ozick, me “Teatri dhe drama” të Erenestina Halilit, “Dimensionet e identitetit multikulturor në letërsinë e vjetër shqipe” të Ilir Brecës dhe “Erosi i përçmuar” të Marjela Prognit-Pecit. Përkthyesit që kontribuan në këtë numër janë: Bajram Karaballi, Gëzim Aliu, Alket Çani, Sulejman Dërmaku, Alfred Beka, Arben Idrizi, Erion Karaballi, Qerim Ondozi, Arta Hallaçi dhe Rexhep Maloku.



ÇFARË TË BËJMË ME MAJAKOVSKIN

Nga Vittorio Strada

Ç'të bëjmë me Vladimir Majakovskin? Me Majakovskin që për antonomazi është "poeti i revolucionit"? I një revolucioni të ashtuquajtur i "Tetorit" i cili në fillim u ngrit në qiell nga të shumtit, nga Majakovski edhe më me zjarr se kushdo tjetër, kurrë sot është stigmatizuar nga shumica dhe a nuk ishte i tillë ai që në fillim për cilindo që s'ishte verbuar nga shkëlqimi i një "bote të re" imagjinare? Pyetja "Ç'të bëjmë me Majakovskin" si dhe me këngëtarë të tjerë të ringjalljes së kuqe, është e pashmangshme tani që kolosi i ndërtuar në terrenin e asaj përmbysjeje të padëgjuar është në rrënim, provë kjo e pasigurisë së materialeve dhe e gabimeve të projektit. Veç kësaj, nuk bëhet fjalë aspak për një pyetje pa vend, po të kujtojmë deklaratën e bujshme të futuristëve (më 1912), e firmosur që atëherë nga i riu Vladimir, i cili urdhëronte që "të hidheshin nga anija e modernitetit" Aleksandër Pushkini dhe "klasikët" e tjerë që konsideroheshin vjetërsira dhe pa vlerë nga ai që, si homonimet italianë të këtij grupi të kryesuar nga Marineti, për t'u kualifikuar, duke kapërcyer të tashmen dhe të kaluarën, shpallej flamurtar i së Ardhmes. Nga "anija e modernitetit" e mijëvjeçarit të ri mos duhet "hedhur jashtë" ndoshta një klasik "i avangardës" si Majakovski, sepse është i plakur dhe i papërshtatshëm? Një përgjigje e miratuar nga disa është se poezia majakovskiane, fajtoje se ka ekzaltuar një revolucion kriminal që midis shumë të tjerësh, vrau dhe torturoi shumë poetë, i përket tashmë një errësire të merituar: ajo shtrihet në pluhur, nën rrënojat e ndërtesës kolosale komuniste së bashku me shumë figura të tjera të së njëjtës stampë ideologjike. Por nuk mund të mohojmë se poezia e Majakovskit, edhe pse e shfronësuar nga vendi qendror që i ishte dhënë në panteonin e "regjimit të vjetër", ekziston dhe reziston edhe, sepse ajo nuk është një kufomë për të cilën mund të thuhet "parce sepulto" (e varrosur).

Një përgjigje tjetër na këshillon që të provojmë te Majakovski operacionin të cilit duhet t'i nënshtrohet trashëgimia e shumë personazheve të shkëlqyer: të hiqet ajo që është e vdekur

(ditirambi politik) dhe të ruhet ajo që është e gjallë (lirika e dashurisë). Por kjo ndërhyrje e ka të keqen këtu se, cungon një organizëm ku gjithçka është e lidhur dhe prerja e një pjese që quhet e nekrotizuar dëmton pjesën që mbijeton. Parashtrihet edhe një zgjidhje tjetër: ta quajmë Majakovskin, jo poetin e revolucionit, por një viktimë të këtij revolucioni, një lloj zhongleri tragjik i pushtetit të ri: ta quajmë, jo një poet të oborrit të autokracisë së re bolshevike, por një demaskues paradoksal të miteve revolucionare, të fuqizuara nga ai vetë që shihte sa lot dhe sa gjak kullonte Molloku (përbindëshi) i ri i nderuar prej tij.

Të pranosh këtë zgjidhje nuk do të thotë të falsifikosh Majakovskin, duke i ndërtuar një fytyrë ndryshe nga e tija, përkundrazi, ta defalsifikosh duke i hequr maskën zyrtare që i ka vënë për dhjetëra vjet "realizmi socialist". Megjithatë edhe kështu Vladimir Majakovski do të skematizohet dhe, gjëja që do të humbiste do të ishte kompleksiteti dramatik i fatit të tij dhe i poezisë së tij që nuk e ka shoqen në letërsinë e Nëntëqindtës, ku nuk mungojnë njerëz si ai që iu nënshtrua miteve të reja politike dhe si Celini iu nënshtrua joshjes makabre të nazizmit ose si Paundi që e gjeti të përshtatshëm fashizmin për muzën e vet, për të mos folur për turmën, me Brehtin në krye, që u rreshtua me komunizmin e epokës staliniste.

Është "dukuria Majakovski" që perceptohet në unitetin e tij të thellë të jetës dhe poezisë brenda epokës së revolucionit të parë total e totalitar të shekullit XX, lidhur me të cilin emrat, edhe ata më të shquarit që i përmendëm më sipër kanë si tipar që erdhën pastaj, kur nuk kishte më vend për iluzion dhe shumë prej tyre e bënë këtë nga cinizmi.

Duhet të ndjekim rrugën ekzistenciale dhe krijuese të poetit duke u nisur nga një pikë fikse, e vetmja e padiskutueshme, por për këtë, jo më pak enigmatike për biografinë e tij të vuajtur: ajo e vdekjes me vetëvrasje më 1930. Mund të themi se edhe kjo pikë është e pasigurt, meqë vdekja e Majakovskit është vënë në dyshim përsa i përket mënyrës së kryerjes së saj: vetëvrasje apo inskenim? Në rastin e dytë, autore dhe regjisore e simulimit makabër, do të ishte ajo policia politike dhe, ai regjimi, vegël e të cilit ajo ishte, që ndiqte me një interesim të vëmendshëm jetën e poetit dhe do të vendoste më në fund, kur ajo po i shpëtonte nga dora dhe, duke pasur parasysh famën e personit, po bëhej e rrezikshme për atë forcë revolucionare, bard i së cilës poeti ishte.

Nuk do të ishte pa interes të ndiqej ky version virtual, por i pakuptimtë, pasi nuk do të arrinte në asnjë gjë të sigurt. Nga ana tjetër, nëse pranohet teza, e besueshme dhe bindëse, e vetëvrasjes së vërtetë edhe, kjo do të mbante erën e një vrasjeje të bërë, jo nga ajo policia e fshehtë, ("çekistët") së cilës Majakovski i kushtoi një admirim të devotshëm që, veçanërisht, sot, habit dhe ngjall neveri, por nga regjimi i hyjnizuar nga ai si shpëtim i vetëm universal dhe i tiji personal. Në këtë dritë Majakovski është poet i një revolucioni jo rrëzëllues e triumfues, por vdekjeprurës dhe mistifikues: një poet që i tunduar nga një instinkt i papërmbajtshëm vdekjeje, në luftë me një vullnet të dëshpëruar jete të revolucionit si një jetë e rreme, gjeti një iluzion të përkohshëm mbijetese.

Tri vetëvrasje të mëdha shënojnë historinë e poezisë ruse të Nëntëqindshit: vetëvrasja e Sergej Eseninit më 1925, vetëvrasja e Vladimir Majakovskit më 1930 dhe ajo e Marina Cvetajevës më 1941 (e ngjashme, por e ndryshme është lista e poetëve të vrarë, nga Nikolaj Gumilovi, Osip Mandelshtami dhe të përndjekurit, që nga Ana Ahmatova deri te Boris Pasternaku). Më e bujshmja që padyshim vetëvrasja e Majakovskit e cila përveç skandalit për atë gjest të kryer nga poeti më i shquar i regjimit komunist, me barrën e enigmave domethënëse, u bë shkak për gjykime me vlerë të lartë, si ato të Andrea Bretonit dhe Roman Jakobsonit dhe la një gjurmë të thellë te Boris Pasternaku që asaj ngjarje i kushtoi faqet më intensive të Lejeqarkullimit të tij. Më pak e paralajmëruar që vetëvrasja e Marina Cvetajevës e cila ishte gjithashtu më e kuptueshme: pas kthimit në Bashkimin Sovjetik, më 1939 dhe arrestimit të burrit dhe të vajzës së saj dhe pastaj, pas largimit të saj, në fillim të luftës në një lokalitet të humbur tartar, Elabuga, pa mjete jetese, e izoluar dhe e ndrydhur ("Ka një vit që hahem me vdekjen. Gjithçka është monstruoze dhe e tmerrshme", shkruan në ditar pak më parë se të vriste veten), Marina kishte vepruar "logjikisht" siç tha me kuptim dashamirës djali i saj Mur.

Përsa i përket Eseninit largimi i tij vullnetar nga jeta, pas përpjekjesh të ndryshme të dështuara, nuk ngjan e errët, po të mendohet për tëhuajsimin e tij nga realiteti i pasrevolucionit, për jetën e tij të çrregullt që bëhej shkak që ai të gjente miqësira mes fundërrinave të shoqërisë dhe, midis kapove të policisë së fshehtë, si dhe për alkoolizimin që u bë shkak që ai të mbyllej

në një klinikë psikiatrike pak para udhëtimit të tij për në Leningrad, ku në një nga dhomat e hotelit Ndërkombëtar (tashmë Angletere), preu venat dhe u var në një nga dritaret (edhe në rastin e tij u përhap versioni që vetëvrasja kishte qenë e inskenuar nga çekistët, por s'u besua). Në lidhje me vetëvrasjen e Eseninit që shkaktoi në mënyrë epidemike një valë vetëvrasjesh si imitim, çështja më interesante qëndron në marrëdhënien me Majakovskin. Esenini, me gjakun e damarëve të vet, shkroi dy vargjet e tij të fundit:

*Në këtë jetë të vdesësh nuk është e re,
por as të jetosh s'është e re sigurisht...*

vargje këta që mbetën më të gdhendur nga vdekja e poetit, aq sa Majakovski mendoi se ishte detyra e tij sociale "të paralizonte në mënyrë të ndërgjegjshme efektin e atij testamenti poetik, "të bëjë të zakonshëm fundin e Eseninit, të tregojë në vend të forcës tërheqëse të vdekjes, një tjetër bukuri, pasi njerëzimi punëtor kishte nevojë për të gjitha forcat, për gjersa revolucioni ishte në fillim". Bëhej fjalë që të çestetizohej ajo vdekje duke i kundërvënë atyre vargjeve jo analiza sociologjike ose fjalë politike, por vargje të tjerë, po aq të gdhendur. Poezia "Sergej Eseninit," në të cilën Majakovski kërkon të neutralizojë edhe me anë të ironisë fundin e poetit, mbyllet me këta vargje, gjithashtu po aq të famshëm si ata të Eseninit:

*"Në këtë jetë nuk është e vështirë të vdesësh.
Të jetosh është shumë më e vështirë".*

Të jetosh një jetë kolektive, "t'u shkëpusësh gëzimin ditëve të ardhshme, pasi "planeti ynë nuk është aq i ndërtuar për gëzimin" (janë fjalë të së njëjtës poezi): kjo ishte detyra që Majakovski poet i revolucionit i vinte gjithë poezisë dhe në radhë të parë, vetes, gati, siç thotë në një varg tjetër të tij, që t'i shqyejë fytyrën këngës së vet, domethënë të sakrifikojë prirjen e tij lirike mbi altarin, për ndërtimin e një bote të re dhe për njeriun e ri.

Mbi këtë sfond Marina Cvetajeva krijoi një legjendë të vetën të bukur për vdekjen e Majakovskit: ai pasi kishte përdorur vokacionin e vet duke i shërbyer një force keqbërëse që ai e kishte pandehur të mirë, qenkej penduar sepse "dymbëdhjetë vjet rresht, njeriu Majakovski, vrau brenda vetes Majakovskin poet, në të trembëdhjetin, poeti u çua dhe vrau njeriun. Nëse ka në këtë jetë një vetëvrasje, ajo nuk është atje ku e shohin dhe zgjati, jo aq sa zgjati çasti i tërheqjes së këmbëzës së revolverit, por dymbëdhjetë vjet jetë,,

Vetëvrasje "lirike" ajo e Majakovskit pra? Fitorja e poetit mbi njeriun, e lirisë mbi shërbimin?, e frymëzimit mbi politikën? Por te Majakovski që vret veten nuk ka "gjurmë" pendese, as nuk mund të kishte se, po të kishte pasur, do të shkatërrohej monumenti që Majakovski poet dhe njeri, i kishte ndërtuar vetes gjatë gjithë jetës dhe donte ta ruante edhe për shokët pasardhës". Letra e fundit (dikush ka dyshuar se ka pasur një tjetër, e sekuestruar dhe e mbajtur e fshehtë nga policia politike, me sa duket, kjo është legjendë), nuk është aspak një mesazh i "lartë", që ia kalon "angazhimit" ideologjik dhe politik të mëparshëm, e përqendruar siç është, te çështjet e "ditës", pa llogaritur aluzionet te polemika letrare më e zakonshme.

Më afër thelbit të kësaj vdekjeje janë, me forcën e tyre largpamëse, fjalët përmbyllëse te "Lejekalimi" i Boris Pasternakut për të cilin Majakovski i gjallë dhe i vdekur, poet dhe njeri, futurist dhe komunist, zuri një vend qendror dhe edukues: "nën dritaren e dhomës ku shtrihet kufoma e Majakovskit," afër murit, ishte shteti ynë i paparë kurrë, shteti i pamundur që çan nëpër shekuj e mirëpritet përgjithmonë.

Dhe shton: "Vetëm në të, risia e kohës klimatikisht në gjak. Ai ishte krejt i çuditshëm për shkak të çudive të epokës, ende gjysmë të parealizuar". Nga ky vizion misterioz i një Pushteti, "të paparë kurrë" dhe i pamundur, por real, çudia e të cilit dhe risia revolucionare, duket i ngjashëm me këngëtarin e saj të vetëm, të ndierë dhe, vërtet të ndierë (i asaj qytetarie,

ishite i vetmi qytetar), le të kalojmë tani në një konsideratë më të qartë dhe të thjeshtë mbi lëngatën e errët që minonte Majakovskin dhe që i jepte shpirt fshehtësisht poezisë së tij, duke e çuar atë në aktin final të vetëvrasjes. Është dëshmia e Lilja Brikut, grua që edhe kur marrëdhënia e tyre erotike u ndërpre, mbeti si një kushtëzim i përhershëm në jetën e Majakovskit: kjo grua ambicioze dhe tekanjoze që sëmuri një varg të gjatë burrash, qe figura qendrore dhe fatale e fatit të poetit, ashtu si burri i saj, Osip Brik, qe për të një lloj mësuesi politik dhe letrar, që të dy bashkëshortët ishin të lidhur me policinë politike dhe me personazhet e saj të errët.

Në kujtimet e saj, Briku shkruan: “Mendimi i vetëvrasjes ishte sëmundja kronike e Majakovskit dhe si çdo sëmundje kronike, ajo bëhej më e mprehtë në rrethana të disfavorshme”. Ja një episod: “Në vitin 1916, në mëngjes herët, më zgjoi një telefonatë. Zëri i ulët, i zymtë i Majakovskit: “Po ia heq vetes. Lamtumirë Lilik”. Bërtita: Pritmë!”, hodha diçka sipër fustanit, shpejtova hapat nëpër shkallë, u luta, nguca, qëllova me grushta mbi shpinën e karrocierit. Majakovski më hapi portën. Në dhomë, mbi tavolinë ishte një pistoletë.

Ai tha: “Shtiva, nuk ndezi, s’e provova edhe një herë tjetër, të prita ty”. Më në fund Briku kujton: “Kur në 1956 erdhi në Moskë Roman Jakobsoni, ai më kujtoi një bisedën tonë të 1920-ës dhe ai më tha: “Nuk mund ta përfytyroj Volodjan plak me rrudha”. Unë iu përgjigja: “Nuk do ta arrijë kurrë pleqërinë ai, do të shtjerë kundër vetes me siguri. E qëllloi njëherë veten dhe s’i ndezi. Por s’do të ngjasë përherë kështu!”. Dhe përfundoi: “Para se të shtinte kundër vetes, Majakovski hoqi karikatorin nga pistoletë dhe la në tytën e saj vetëm një plumb. Duke e njohur, jam e sigurt që ai i besoi fatit duke menduar se po të mos ishte e shkruar, do të kishte bërë prapë një shkrepje bosh dhe do të do të mbeste gjallë”.

Në interpretimin e Brikut, mendimi i herëpashershëm i vetëvrasjes është reduktuar në dukuri të jetës së përditshme (frika e pleqërisë), ndërsa Majakovski ishte i shqetësuar nga vdekja si zhdukje totale e botës reale, trupore, dhe i shpërblyer nga miti i ringjalljes si kthim në këtë botë, temë e pranishme kjo në poezinë e tij.

Burri i Liljas, Osip Brik, inteligjenca e ftohtë e të cilit ishte ngurtësuar në tmerret e torturave dhe pushkatimet dhe bodrumet e policisë politike sovjetike, spektator i të cilave ai kishte qenë, e komentoi vetëvrasjen e Majakovskit në mënyrë më pak sipërfaqësore: “Njerëzit nuk vetëvriten për dy arsye: ose pse janë më të fortë se kundërshtitë që i rrethojnë ose pse në përgjithësi nuk kanë asnjë kundërshti”. Dhe pas këtij pohimi, pyetjes pse qëllloi veten Majakovski i përgjigjet: “Është një pyetje shumë komplekse dhe përgjigja është, po kaq domosdoshmërisht komplekse”.

Por ai s’e dha. Fjalët e tij megjithatë tregojnë drejtimin në të cilin duhet të kërkojmë: nëse duhet përjashtuar që Majakovski është pa kundërshti, do të duhet të mendojmë që “kundërshtitë që e copëtonin”, ishin më të forta tek ai dhe që në një farë pike, ta kishte braktisur ajo forcë që i kishte lejuar t’i dominonte. Gjë e cila na çon drejtpërdrejt në zemër të poezisë së tij.

Të thuash se, Majakovski i ri qe futurist, do të thotë të përsërisësh një të vërtetë që duket sheshit, që ideologët sovjetikë kërkuar ta errësonin për t’u theksuar më mirë figura e një Majakovski, poet i revolucionit në frymën e “realizmit socialist”.

Dashuria, vështirësia për të dashuruar dhe për të qenë i dashuruar, për të gjetur një plotësim në marrëdhënien komunikuese, në çastin e tij më mishëror sesa shpirtëror, me tjetrin (tjetrën), është në qendër të kësaj drame që sheh Vladimir Majakovskin, jo vetëm si autor, por edhe si personazh (të mendohet për tragjedinë e tij që titullohet pikërisht, Vladimir Majakovski) mbi një skenë që përkon me gjithësinë ashtu si trupi i poetit - protagonist - priret të njësohet me kozmosin, duke dialoguar në mënyrë polemike me Zotin. Lirika e dashurisë majakovskiane bëhet kështu diçka unike në këtë lloj poezie, një bisedë plot dëshirë dhe e copëzuar. Në të erosi dhe Tanatos takohen dhe largohen, duke aspiruar me një zotërim të pamundur dhe një përjetësim gjithashtu të pamundur. Është një etje për jetë që kthehet kokëposhtë si negativitet i jetës, të jetës këtu, dhe tani në emër të një jete të re që të vijë: Majakovski, Majakovski i parë si futurist është poet revolucionar në shpirtin dhe në gjuhën. Drama e tij (“Kontradikta” për të cilën fliste Brik) qe ajo që, ai bëhej poeti i revolucionit duke transformuar “revolucionin e dëshiruar siç e quajti, në një revolucion të institucionalizuar dhe totalitar, këngëtar i të cilit u bë, duke i lënë vetëm ndonjëherë liri zërit të tij autentik dhe të thellë.

Por edhe te Majakovski poet i revolucionit ka një forcë magjepsë perverse që pengon për të vënë mënjanë vëllimet e veprës së tij të periudhës sovjetike: didaskalizmi i tij utopik, megjithatë është i ndryshëm nga ai partiak i të vegjëlvë dhe gjysmërimuesve të laureuar të regjimit; këci sovjetik i shumë poezive të tij, ka sugjestionin e një ëndrre obsesive: sarkofagu që ai ndërton në poemën “Vladimir Iliç Lenin” ka madhështinë e muzeut analog në sheshin e kuq, i destinuar të mbetet edhe kur të boshatiset nga mumia që mban; realiteti me të cilin dhuna e pakrahasueshme bolshevike këndohet hapur, kalon përfytyrimin e ëmbëlak sentimental që “realizmi socialist” ka kërkuar të japë për disa fatkeqësi të komunizmit; patetike, por e singertë është kritika e tij kundër “burokratizmit dhe filistinizmit”, gati si të ishin këta shkaku i të këqijave të revolucionit, ndërsa “burokratike” dhe “filistine” ishte

partia që poeti e hyjnizonte, duke e idealizuar; më në fund vetëvrasja konkluzive, vetëvrasja letrare dhe poetike që mbyll një lojë kontradiktash, jo të dominueshme; vulë katastrofike dhe shpëtimtare e fatit majakovskian, e tensionit të tij ateisto - religjioz që në revolucion kishte gjetur një zgjidhje surogato të tillë, si kërkesa e tij e dashurisë të çdo grua, gjente një kënaqësi kalimtare.


Nëse te i riu Majakovski shikojmë një revolucionar metafizik në luftë me Zotin, dhe te Majakovski, më pak i ri shikojmë pasuesin e një Kishe revolucionare të varfër në besim, por të pasur në pushtet, thyejmë një klishe të pranuar, qoftë tek ai që e interpreton poetin duke përdorur çelësin e “avangardës”, qoftë tek ai që e kufizon në skemën e “realizmit socialist”, një lexim i Majakovskit futurist nxjerr në dritë një element risie; referimin e fortë me Niçen, me Zarathustrën, në veçanti. Mund të shihnim dy Majakovskë, njeri në shenjë e Niçes, tjetri në shenjë e Marksit (dhe Leninit) ose vetëm një Majakovsk në të cilin impulsi elementar i revoltës nihiliste kundër botës së përbërë prej (borgjezëve) e ve atë tragjikisht në shërbim të një revolucion real (programatik) dhe institucional (komunist). Por këtu ka vend që të hapet një analizë mjaft e gjerë.

Si ta lexojmë sot Majakovskin? Secili në mënyrën e vet, natyrisht. Kjo që propozohet këtu ka si sfond, jo vetëm tragjedinë dhe vetëvrasjen e poetit, por tragjedinë dhe vetëvrasjen e revolucionit që ai e quajti të tijin, katastrofa e atdheut të tij (150000000 sipas titullit të një poeme të tij mbi Rusinë) dhe për gjithë atë “internacionale”, pjesë të së cilës e ndjente veten dhe ai si shokët e tij (*Internacionalja e pestë*, titulli i një tjetër poeme të tij). Të mos e cungojmë veprën e Majakovskit, por as edhe të mos ta përsërisim dobësisht në stilin e vjetër të fanfarës revolucionare dhe të retorikës tribunale. Poezia e ndez shkëndijën e saj të së vërtetës në heshtjen, në kontaktin rastësor ose të kërkuar mes dy shpirtave, e njërit që e ka shkruar dhe të tjetrit që e lexon. Kjo mund të duket antimajakovskiane, antifuturistike, antirevolucionare.

Por britma e sfidës dhe e dhimbjes së Majakovskit, na mbërrin e topitur. Si një jehonë e shuar është thirrja e tij shungulluese e propagandës. Zëri i tij autentik na prek në shpirt, duke na bërë të ndiejmë vetminë e tij, si tonën, dashuria e tij, si të jetuar nga ne, ankthin e tij dhe shpresën e tij si ato që na pushtojnë edhe ne.

Poet deklamues, Majakovski kapërcen provën e diksionit të brendshëm, në hapësirat e heshtura të së cilës, fjala e tij e ashpër, tingëllon më e gjallë se në fjalën zhurmuese të origjinës, pranë zërave të ndryshëm që, të ngjyrosur nga gjuhë të ndryshme të poezisë universale, formojnë mikrokozmosin e imazheve që secili personalisht krijon dhe ndjek brenda vetes pambarimisht. Pjesa tjetër është artefisi letrar.

Përgatiti dhe përktheu: FASLLI HALITI



PENGESA ËSHTË RRUGËDALJA



RYAN HOLIDAY

Minerva